



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 7 QERSHOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 7. JUNA 2012. GODINE**

**QERSHOR - JUN
2012**

R e n d i i d i t ë s

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Miratimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me rolin dhe pozitën e fëmijëve në Kosovë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër,
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Komisionit për përzgjedhjen e kryesuesit dhe
të anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2011.

D n e v n i r e d

1. Vreme za izjašnjavanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja;
3. Usvajanje zapisnika sa prošle sednice;
4. Usvajanje preporuka Komisije za ljudska prava, polnu ravnopravnost, nestala lica, i
peticije o ulozi i položaju dece na Kosovu;
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti potrošača;
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o slepim i delimično slepim osobama;
7. Razmatranje Predloga odluke Komisije za izbor Predsednika i članova Upravnog
odбора Kosovskih penzijskih ušteta;
8. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Kosovske agencije za privatizaciju;
9. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Komisije za pravnu pomoć, za 2011. godinu.

E enjte, më 7 qershor 2012

Seancën e drejton kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Pasi kemi të bëjmë me pikën e parë të rendit të ditës - Koha për deklarime jashtë rendit të ditës, mund t'ia fillojmë seancës.

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është paraparë 30 minuta, diskutimet, në emër të grupeve parlamentare, zgjasin 5 minuta, në emër të deputetit, 3 minuta, replika nuk ka.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sot kam dal t'i përcjell shqetësimet e banorëve të fshatit Polac, komuna e Skenderajt, që kanë të bëjnë me mospërfundimin e rrugës magjistrale Vushtrri-Skenderaj, e që ka filluar para 7 vjetëve dhe kjo rrugë kalon nëpër fshatin Polac.

Ky projekt ka filluar para 7 vjetëve. Edhe sot kur po diskutoj në këtë foltore ende nuk ka përfunduar. Qytetarët e Polacit, pa hezitim, i dhanë pronat e tyre që konsiderohen si tokat më pjellore në atë anë, prandaj nuk e meritojnë këtë ndëshkim që po u bëhet plot 7 vjet me radhë.

Kjo rrugë, jo vetëm që është bërë skëterrë për qytetarët e Polacit, të cilët nga mihjet e ekskavatorëve e kanë të pamundur t'u qasin tokave të tyre për t'i punuar, është bërë skëterrë edhe për të gjitha fshatrat rreth Çyçavicës, që duhet të kalojnë nëpër këtë rrugë për të shkuar në Skenderaj.

Fatkeqësisht, këtë rrugë dy herë në ditë duhet ta kalojnë edhe shumë fëmijë të fshatit Polac për të shkuar në shkollë, të cilët në të gjitha mënyrat i ekspozohen rrezikut, si nga pluhuri, ashtu edhe nga shumë faktorë tjerë. Andaj, kërkoj nga Ministria e Infrastrukturës që këtë problem ta zgjidhë me urgjencë, sepse durimit shtatëvjeçar të banorëve të kësaj ane ka filluar t'i vijë fundi.

Presioni që këta banorë u bëjnë strukturave komunale dhe neve si deputetë të asaj ane, për ta realizuar të drejtën e tyre si të gjithë qytetarët tjerë të Republikës së Kosovës dhe për t'i adresuar problemet e tyre në institucionet qendrore është i përditshëm dhe shumë i arsyeshëm. Andaj, kërkoj edhe një herë nga Ministria e Infrastrukturës që të veprojë arsyeshëm në zgjidhjen e këtij problemi dhe kësaj vuajtjeje të banorëve të fshatit Polac dhe fshatrave rreth Çyçavicës, të komunës së Skenderaj, t'i vijë fundi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Falemnderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Do t'i ngre dy çështje që lidhen njëra me tjetrën. Mediumet tona duhet të jenë në shërbim të vlerave, kultivimit të tyre, si dhe avancimit të demokracisë. Por, transmetuesi publik, me qëllim apo pa qëllim, po politizohet dhe po banalizohet skajshëm nga skenaristët dhe folësit e porositur kur lansojnë në veten e parë lavdërime pa fije mbulese, gënjeshtër dhe dezinformata me porosi të shefave të tyre të mendësisë së mykur totalitare.

Populli i Kosovës është falënderues për mbështetjen e madhe që ka dhënë Shqipëria dhe populli i saj për Kosovën. Kuadro, njerëz të thjeshtë dhe deri luftëtarë vullnetarë, pavarësisht bindjeve politike, kontribuuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Por, disa dogmatikë, mbeturina të sistemit të së kaluarës edhe sot 13 vjet pas çlirimit dhe 4 vjete pas pavarësisë së Kosovës, pështillen jo rastësisht nëpër Kosovën tonë, duke shfryrë epshet e propagandës staliniste në shërbim të së majtës ekstreme shumë kriminale e korruptive.

Njerëzit e përtokur moralisht dhe të rrjedhur mendërisht flasin marrëzira shumë tendencioze dhe të kamufluara me krim dhe tani duke e përdorur Televizionin Publik, apo them më mirë, taksat e qytetarëve të Kosovës, janë të papranueshme dhe të dënueshme. Të zbrazësh sharje kundër rivalit politik apo kundërshtarit personal, madje edhe pas vdekjes, është një krim i pamoralshëm dhe krejt i pafalshëm. Gënjeshtërve secilën herë janë duke iu zvogëluar këmbët, çdo diktaturë që fshihet pas gënjeshtresë e krimit dhe sa më shumë që zgjat kjo, është aq tmerruese dhe bëhet për të ardhmen dhe demokracinë.

Këto gënjeshtër kobzeza, fatkeqësisht, të transmetuara nëpërmjet një emisioni në RTK mund të krahasohen me regjimet më gjakatare të rajonit ballkanik, e në disa segmente i tejkalojnë ato. Kush është Kudusi Lame që hedh helm ndaj figurave tona çlirimtare, luftës institucionale dhe arkitektëve tonë të lirisë e pavarësisë, duke filluar nga heronjtë: Ibrahim Rugova, Ahmet Krasniqi, Tahir Zemaj, Sali Çeku e shumë luftëtarë të tjerë? Kush është ai keqbërës që në tokën e lirë të Kosovës dhe në shtetin tonë të pavarur merr guxim të hedhë helm gjarpri, si në kohën e Rankoviqit, nëpërmjet një gazetari shërbëtor që në gjuhën popullore nuk ka terminologji tjetër, pos të epitetit "defatore"

Ky falsifikator që u pasurua shumë në tragjedinë tonë, them shkurt me paratë e dedikuara për luftën, njeriu që i kërcënoi edhe krerët çlirimtarë të Brigadës në Koshare, që të mos guxojnë për ta thyer kufirin shqiptaro-shqiptar, që edhe sot ta denigrojnë të vërtetën dhe ta sulmojnë të ardhmen.

Gjaku i atdhetarëve është derdhur rrugëve të Kosovës, edhe pas luftës, e një pjesë e atyre që kanë gisht sot nuk kanë si të veprojnë ndryshe, përpos që në lokalet e Policisë të stimulojnë policë të inkriminuar për t'i vjedhur dëshmitë, dosjet e kamufluara me vjedhje të drogës dhe vjedhje të arit, të stimulojnë policë që të vendosin bomba mu në mes të Prishtinës, për t'i vrarë qytetarët e pafajshëm, policë që grabitin biznesmenë dhe policë si udhëheqës të Njësisë së Hetimeve, që dyshohen të implikuar në vrasjet e biznesmenëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lutem, të mos shfrytëzohet Parlamenti për t'i sulmuar mediet. Fjalën e ka deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Falemnderit, kryetar!

Më 10 qershor të vitit 2010, në Kuvendin e Republikës së Kosovës u miratua Ligji për Kryqin e Kuq. Në nenin 14, paragrafi 1.7, të po këtij ligji thuhet: “Për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj, Kryqi i Kuq i Republikës së Kosovës siguron mjete financiare nga sigurimi i obligueshëm i atyre mjeteve 1% nga bruto-primi i vlerës së sigurimit të automjetit.

Por, ajo që ka ndodhur deri më tani është që kompanitë e sigurimeve e kanë shpërfillur Kuvendin duke mos e respektuar këtë dispozitë ligjore tash e dy vjet, kur dihet se Kryqi i Kuq zhvillon aktivitet humanitar, vullnetar e jo fitimprurës, madje po këto kompani kanë kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që ta hedhin poshtë këtë dispozitë, por Gjykata Kushtetuese e ka refuzuar kërkesën e tyre dhe është konsideruar si kërkesë e padrejtë.

Në lidhje me këtë, përveç që Kryqi i Kuq ka pasur takime me Bankën Qendrore të Kosovës, ata gjithashtu i janë drejtuar me anë të kërkesës për zbatimin e këtij ligji Bankës Qendrore, më 28.9.2010. Gjithashtu, më 23.11.2010 dhe më 12.7.2011, po ashtu më 27.7.2011, BQK-ja si autoritet mbikëqyrës i kompanive të sigurimeve i ka kthyer letër Kryqit të Kuq dhe përgjigjja të cilën e ka marrë nga guvernatori i kësaj banke ka qenë: “Këtë letër duhet t’ua dërgoni kompanive të sigurimeve”.

Gjithashtu, letrën e njëjtë Kryqi i Kuq ia ka drejtuar edhe Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Sigurimeve, por edhe sot e kësaj dite nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.

Për fund, kompanitë e sigurimeve duhet t’i kryejnë obligimet e tyre ligjore, t’i respektojnë ligjet që dalin nga ky Kuvend, duke filluar edhe atë prej datës së hyrjes të këtij ligji në fuqi t’i kryejnë obligimet e veta në mënyrë retroaktive.

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Ramiz Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë,

Sot do t’i shpreh shqetësimet e bashkëqytetarëve tanë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Kosovës për çështjen e pagesës së sigurimit të automjeteve dhe të makinave, që është për 20 euro për 7 ditë.

Ne e dimë që këtë sigurim mund ta kthejmë edhe në pagesë njëditore, në mënyrë që vizituesit tanë ta shfrytëzojnë territorin e Republikës së Kosovës së paku për transit, sidomos gjatë pushimeve vjetore, kur preshevarët mund të shkojnë në Republikën e Shqipërisë, duke e përdorur territorin e Republikës së Kosovës dhe duke i shenjuar autostradat dhe duke përdorur objektet hoteliere-tregtare në mënyrë që Buxheti i

Republikës së Kosovës të mbushet nga këto taksa, e të mos dëmtohen shoqëritë e sigurimeve.

Njëkohësisht, nëse e shohim që një qytetar i Preshevës duhet të vijë rregullisht në Kosovë, duhet të paguajë sigurim për automjetin mbi 1 000 euro në vit dhe nëse i shohim që edhe mjetet transportuese që qarkullojnë nëpër Kosovë që paguajnë taksa, u bie që sigurimin ta paguajnë mbi 5 000 euro në vit, në këtë mënyrë drejtpërdrejt e shtrenjtojnë produktin, repromaterialin dhe prodhuesit tanë dalin më të shtrenjtë në raport me prodhuesit e tjerë të regjionit.

Prandaj, kisha kërkuar nga Qeveria që ta rishqyrtojë mundësinë e pagesës së taksës së sigurimit të automjeteve dhe të makinave, duke nisur nga një ditë apo nga dëshira e qëndrueshmërisë së tyre në Republikën e Kosovës.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Bugün Kosova hür ve tüm inançlara saygılı, aynı zamanda halkımızın inançlarını yaşayabilme özgürlüğü olan ve Anayasal hak olarak garanti altına alınmış bir devlettir.

Bu inançları yaşayabilmek ancak ibadet etmekle olur, bu ibadet yerlerimizden en fazla olan tabi ki camilerimizdir. Bugün sayısını bilmediğimiz kadar Kosova'da camilerimiz ibadete açık ve Müslümanların hizmetindedir.

Bu camilerimiz İslam Birliğine bağlı olan ibadethane olarak bilinmektedir. Bu camilerimiz hiçbir şekilde bir ticarethane, bir şirket, bir dükkan değildir, camilerimiz kar ve kazanç elde eden bir kurum değildir, ama camilerimiz maalesef bugün bir şirket, bir dükkan gibi elektrik ve su parası ödemektedir, yani şirketlerin ödemiş olduğu elektrik tarifesiinden camilerimiz faturalandırılmaktadır.

Sayın yetkililer buna son vermeniz gerekir, Kosova'nın bağımsızlığına kadar bu ibadethaneler bu tür faturaları ödemiyordu, şimdi Kosova'nın bağımsızlığı ile bu tür ödemeler zor durumda olan bu camilerimizin daha da zora sokmaktadır, bu camilerimizin halktan para toplamaktan baska careleri kalmamıştır. Kosova devleti eğer tamamiyle bu ödemeleri kaldıramıyorsa en azından ev tarifesiinden faturalandırın..

Sot Kosova është një shtet i ri dhe një shtet që i respekton fetë. Gjithashtu, Kosova është një shtet, në të cilin të gjitha të drejtat janë garantuar me Kushtetutën e Kosovës që, sipas kësaj, qytetarët e Kosovës janë të lirë në përcaktimin e tyre fetar.

Respektimi i feve realizohet nëpërmjet riteve në xhami. Numri i xhamive në Kosovë është i madh, ato në çdo kohë janë të hapura për besimtarët myslimanë.

Të gjitha xhamitë janë të lidhura me Bashkësinë Islame dhe janë vend i adhurimit. Këto xhami nuk janë vend biznesi apo shitore, xhamitë nuk janë institucione të përfitimit, por fatkeqësisht sot xhamitë u nënshtrohen obligimeve sikur bizneset, siç është rasti me

pagesën e rrymës, ujit etj. Me një fjalë, xhamitë janë të obliguara ta paguajnë rrymën dhe ujin si ndonjë vend i biznesit.

Nëse shteti i Kosovës nuk është në gjendje ta parandalojë këtë, harxhimet e xhamive duhen të faturohen nga tarifa e shtëpisë. Këto janë kërkesat e xhematit.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Skender Hyseni.

SKENDER HYSENI: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Janë dy çështje, të cilat më kanë bërë që sot të dal para jush dhe t'i ngre si shqetësim të përbashkët.

E para janë paralajmërimet bombastike nga përfaqësuesit e Qeverisë për anëtarësim, përkatësisht aplikim të Kosovës për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Këto paralajmërimet janë shqetësuese, sepse tregojnë dy gjëra në esencë, njëra se ka gjasa që Qeveria nuk është në dijeni për procedurat e anëtarësimit në OKB.

Dhe dy, ka po ashtu përpjekje që Kosova të dërgohet në drejtim të Klubit të Saharës Perëndimore dhe të Palestinës.

Anëtarësimi në OKB është procedurë e thjeshtë, e cila bëhet nëpërmjet dorëzimit të aplikacionit në Këshillin e Sigurimit të kësaj organizate. Është Këshilli i Sigurimit që i rekomandon Asamblesë së Përgjithshme pranimin, përkatësisht hedhjen në votim të kandidaturës së një vendi. Ky rekomandim ndodh vetëm atëherë kur asnjë nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit nuk e ushtron të drejtën e vetos dhe ju të gjithë e dini që në Këshillin e Sigurimit janë 5 vende anëtare me të drejtë vetoje, dy nga të cilat janë Republika Popullore e Kinës dhe Federata Ruse dhe në një të ardhme bukur të largët ne mund të parashohim që edhe njëra, edhe tjetra, në rastin e Kosovës, do ta ushtrojnë të drejtën e vetos.

Po kështu, ka pasur paralajmërimet se Qeveria mund të aplikojë për status vëzhguesi. Kjo është akoma më e dëmshme dhe më e rrezikshme, sepse Kosovën drejtpërdrejt e çon në drejtim të klubit të ashtuquajtur të vendeve ose entiteteve pa identitet, ose me gjysmë identitet, siç është Sahara Perëndimore dhe Palestina.

Çështja tjetër që më ka shqetësuar këto ditë është një debat i heshtur në opinion, i kamufluar për natyrën e konflikteve në ish-Jugosllavi, përgjithësisht, por një debat bukur i ashpër në qarqet diplomatike dhe në komunikime diplomatike.

Nëse luftërat në ish-Jugosllavi ishin konflikte të thjeshta ndëretnike, apo ishin luftëra për çlirim, luftëra për dalje nga dhuna, nga dominimi, në rend të parë serb, i cili synonte të vendoste një dominim dhe sundim të egër mbi gjithë popujt e ish-Jugosllavisë.

Duke marrë shkas nga një editorial i kryeministrit këto ditë, ku disa përplasjeve gjatë luftës në Kosovë u referohet si konflikte ndëretnike, ka përpjekje që edhe lufta e Kosovës

të prezantohet, të përshkruhet si konflikt i fërkimeve ndëretnike, ku të gjithë janë të barabartë dhe faji është i barabartë. Kjo është, të nderuar kolegë deputetë, e keqe, kjo çon kah një sklerozë totale kolektive që është e dëmshme për Kosovën, është e keqe për Kosovën. Në Kosovë ka pasur një luftë të egër të të sunduarit me sunduesit, një luftë të egër të të pushtuarit me pushtuesin dhe askush nuk mund ta kualifikojë asnjëherë fërkim të thjeshtë ndëretnik Prekazin, a Reçakun, Mejen apo shumë krime të tjera që janë barabar pothuaj me gjenocidin.

Ne e pamë këto ditë presidentin e tashëm të sapozgjedhur serb, Nikoliq, i cili edhe Srebrenicën e quajti një krim të rëndë. Nuk do të shkojë shumë kohë dhe do të thotë një krim ndëretnik e kanë kryer disa të krisur dhe ata të krisur do t'i hedhin para gjyqit. Ndërkaq, shteti i cili e ka sponsorizuar krimin, shteti i cili i ka sponsorizuar të gjitha tragjeditë në ish-Jugosllavi, do të shfajësohet dhe të mos habitemi që shpejt një ditë Serbia do të trajtohet si viktimë e gjithë tjerët si ata që kanë shkaktuar viktima.

Sërish po e them, të nderuar kolegë, ne duhet të jemi të kujdesshëm. Na sugjerohet shpeshherë që e kaluara nuk duhet të kujtohet, bile-bile shkohet aq larg sa thuhet që duhet të harrohet. Unë kujtoj që nuk duhet të harrohet dhe e kaluara duhet të përdoret në funksion të së ardhmes, në funksion të ndërtimit të një të ardhme, pa ato që i ka pasur në të kaluarën, pa tragjedi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Dëshiroj t'i shtroj dy çështje që kanë pak a shumë lidhje njëra me tjetrën. Njërin prej tyre, zoti Kelmendi veç e shtroi, është çështja e pagesës së taksës kufitare të sigurimit. Është për t'u përshëndetur ndërhyrja e Qeverisë dhe vendimi i fundit për uljen e kësaj takse, mirëpo dëshiroj ta prezantoj po ashtu kërkesën e atyre qytetarëve, dhe jo vetëm të bizneseve, por edhe të qytetarëve të zakonshëm nga Presheva dhe Bujanoci, që udhëtojnë shpesh në kufij, që kjo taksë duhet të hiqet fare. Pra, Qeveria duhet ta trajtojë këtë çështje dhe mundësinë që ta heqë fare këtë taksë.

Është thënë si një arsye që kah fundi i vitit të kaluar që Kosova do të jetë pjesë e kartonit të gjelbër, kjo s'ka ndodhur. Zoti kryetar, do të ishte mirë t'ia bëni një kërkesë zyrtare Bankës Qendrore të Kosovës dhe nëpërmjet saj edhe shoqatave të sigurimit ose përfaqësuesve të kompanive të sigurimit, të dihet deri kur do të hiqet kjo taksë, duke e ditur se tash në sezonin e verës kjo taksë do t'i rëndojë edhe qytetarët e Kosovës që punojnë jashtë vendit. Pra, kjo taksë është një ngarkesë jashtëzakonisht e madhe.

Edhe një çështje tjetër dua ta shtroj. Këtyre ditë po bëhet një gjyq i ashtuquajtur kundër Grupit të Gjilanit, në Preshevë. Siç e dimë, në mungesë provash, ata qytetarë që po dënohen atje në mënyrën më të veçantë janë pa mbrojtjen e askujt. Kërkoj nga

institucionet e ndryshme humanitare, ndërkombëtare, vendore e të tjera që të bëjnë sa të jetë e mundur në monitorimin e atij procesi, duke pasur parasysh që institucionet e drejtësisë së Serbisë, në gjendjen e sotme korruptive, po kërkojnë para të mëdha në mungesë të provash për lirimin e tyre. Po ashtu, duke pasur parasysh që ky gjyq është i porositur politikisht, kërkoj edhe një herë nga institucionet e ndryshme që sa të jetë e mundur ta bëjnë monitorimin e këtij procesi që është kryesisht i montuar politik. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Është një temë të cilën Aleanca e ka përmendur në vazhdimësi, por edhe grupet tjera politike, edhe Qeveri. Është qymyri, është thëngjilli, është pasuria më e madhe e Kosovës, të paktën pasuri nëntokësore.

Para disa muajsh, në emër të Aleancës, unë e kam paralajmëruar publikun e Kosovës, se edhe kompanitë e mbetura shumë shpejt do të tërhiqen nga gara për shkak se procesi ka qenë i korruptuar, për shkak se nuk kanë ekzistuar garanci të cilat duhet t'u jepen kompanive, të cilat investojnë shuma kaq të mëdha të mjeteve të tyre, kompanive private.

Fatkeqësisht, për Kosovën e kjo gjë ka ndodhur. Për momentin, nuk ka asnjë të interesuar për të investuar në kapacitete të reja energjetike në Kosovë. Populli i Kosovës, siç e kemi thënë shumë shpesh, për një kohë tepër të gjatë është mbajtur, me shpresën edhe para lirisë, se Kosova ka pasuri aq të mëdha nëntokësore, kryesisht qymyr e thëngjill, sa ky do të mund të ishte elementi i nisjes të zhvillimit të madh ekonomik të Kosovës dhe do të ishte element i cili assesi nuk do të mund ta lejonte Kosovën që të ishte vendi më i varfër në Evropë, ndoshta edhe më gjerë.

Në fund të vitit 2007, projekti ka qenë i gatshëm dhe ka pasur 4 kompani më të mëdha në botë të parakualifikuara, mirëpo ky projekt është ndërprerë. Është ndërprerë atëherë me supozimin se ka qenë i korruptuar. Më vonë, Qeveria ka dalë me idenë e 600 megavateve, dikur kryeministri është kthyer dhe ka thënë prapë 2 100 megavat, së fundi prapë dy herë 300 dhe tani projekti ka përfunduar efektivisht dhe nëse prej sot Qeveria do të jetë ideale në zbatimin e politikave energjetike, do të thotë se jemi vonuar diku shtatë vjet. Shtatë vjet i ka humbur Kosova, shtatë vjetët më të mira të mundshme për t'i zhvilluar kapacitetet e veta energjetike dhe për ta nxjerrë vendin nga skamja.

Qeveria e Kosovës po flet për energjinë e ujin. Të gjithë ata që e dinë çka është energjia dhe që e dinë fizikën, pak e kuptojnë se nëse e gjithë energjia teorike e ujit shfrytëzohet në Kosovë, do të kemi 250 deri 300 megavat energji elektrike, e ju e dini se cilat janë nevojat sot dhe paramendoni cilat do të jenë nevojat e Kosovës nëse ne synojmë t'i punësojmë njerëzit. Nëse synojmë t'i punësojmë njerëzit, duhet të hapen fabrika, duhet të hapen kapacitete industriale dhe nëse këto kapacitete industriale do të hapen, nevoja për energji do të jetë dy herë më e madhe se tash, me një rritje 5-vjeçare për 10%, e cila do të garantonte ulje të punësimit.

Ajo që po ju them, në fund, është se këto politika po e dënon Kosovën që të mbetet vendi më i varfër në Evropë edhe më gjerë, po e dënon popullin e Kosovës, i cili pa fajin e vetin po këqyr se çfarë ka të shesë. E unë po ju them juve si ta zhvillojmë ekonominë e Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryetar!

Në një takim të mbajtur më 23.5.2011, ndërmjet ministrit të Drejtësisë Hajredin Kuçi dhe 12 përfaqësuesve të të gjitha pavijoneve në Burgun e Dubravës, ministri i Drejtësisë u pati premtuar atyre që do ta hartojë dhe përgatisë Ligjin për amnisti, për ta dërguar më tej në Kuvend. Madje, në atë takim, ministri i Drejtësisë e ka quajtur veten edhe avokat i fuqishëm i Kuvendit.

Mirëpo, ajo çfarë ka ndodhur deri më tani, është një mashtrim i radhës i ministrit të Drejtësisë, pasi ai ligj asnjëherë nuk u soll në Kuvend. Dhe, përveç kësaj, ministri i Drejtësisë e ka hequr amnistinë edhe nga Kodi Penal dhe në një dëgjim publik që e kemi mbajtur me Komisionin për Legjislacion, ai e ka quajtur amnistinë si kundër-kushtetuese. Pra, ajo çfarë po ndodh aktualisht në Kosovë është se i gjithë realiteti po bazohet mbi mashtrime.

Ne kërkojmë urgjentisht nga ministri i Drejtësisë që sa më shpejt të jetë e mundur ta hartojë Ligjin për amnistinë dhe ta sjellë më tej në Kuvend. Ju falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Kolegë deputetë dhe ju qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dua të përmend disa ngjarje që e shënuan javën që shkoi. Sipas “Business in Sajder”, Kosova është radhitur në vendin e nëntë, në mesin e vendeve më të varfra në botë. Indeksi i shkallës së varfërisë në Kosovë, sipas “Business in Sajder”, është 53,6%, inflacioni i indeksit të çmimeve të konsumit është 8,3%, ndërkaq papunësia është 45,3%. Kosova, për nga niveli i varfërisë radhitet me vendet si Afganistani, Kenia, Bjellorusia, Namibia dhe Zimbabve.

Me zbutjen e varfërisë, institucionet nuk po merren shumë, sepse qeveritarë e funksionarë të ndryshëm që duhet të merren me luftimin e kësaj dukurie nuk bëjnë pjesë në 53% të qytetarëve të varfër të Kosovës, madje shumë prej tyre as edhe nuk e besojnë këtë.

Është shumë interesante se kjo ngjarje koinçidon me një ngjarje, e cila pjesërisht i përgjigjet pyetjes pse jemi të varfër, pse Kosova, me gjithë përpjekjet e Qeverisë për ta reklamuar vendin, prapë po ngelë aq shumë? Dhe, çfarë ndodh në këtë javë? Ndodh vjedhja në Dhomën e Dëshmive në Stacionin Policor të Pejës, vjedhje kjo që për askënd

nuk është diçka e re, sepse gjatë qeverisjes Thaçi po përsëritet për të dytën herë. Kush po vjedh, roja e shtetit? Dhe pse, sepse në vjedhjen që ka ndodhur në Dhomën e Dëshmive në Prishtinë askush nuk është ndëshkuar? Masat e ndërmarra me rastin e dytë, pasi ky fenomen u përsërit, nuk mjaftojnë. Ministri i Punëve të Brendshme është dashur të japë dorëheqje menjëherë, por kjo vështirë të ndodhë, pasi e dimë se sa janë të lidhur ministrat me karriget e tyre.

Por, ka qenë një opsion tjetër për ta treguar luftën e kësaj Qeverie kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ka qenë opsioni që kryeministri ta shkarkojë ministrin, por as kjo nuk ka mundur të ndodhë, sepse kryeministri atëherë është dashur të japë dorëheqje kur e ka arrestuar për korrupsion shefin e Task-Forcës kundër korrupsionit, prokurorin special Nazmi Mustafi.

Si rezultat i kësaj dhe shumë ngjarjeve të tjera, EULEX-it iu zgjat mandati edhe dy për vjet. Se sa është pozitive kjo do ta elaborojmë një herë tjetër, por për një gjë jemi të sigurt - se edhe për dy vjet të tjera për çdo ngecje dhe dështim në sferën e rendit dhe të ligjit, Qeveria e Kosovës do të ketë kujt t'ia lërë fajin.

Të nderuar qytetarë,

Ka me mijëra arsye pse jemi të varfër, por një është më kryesorja, e ajo është partia në pushtet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta falënderoj deputetin Eqrem Kryeziu, i cili ishte informuar për rastin e familjes Deliu, të fshatit tim të lindjes, e njohur nga masakra që kishin shkaktuar forcat serbe në shtator të vitit 1998 dhe foli në seancën e kaluar për nevojën e mbështetjes institucionale.

Për të shkuar më tej, ajo lagje ende nuk e ka rrugën e asfaltuar. Pritet që në këtë vit, nga një projekt i Komunës së Drenasit, fshati ta ketë rrugën, e për kanalizim dhe ujësjellës as që bëhet fjalë, si dhe për shumë fshatra të tjera.

Dua ta siguroj zotin Eqrem Kryeziu, kolegët tjerë deputetë dhe gjithë opinionin e gjerë, se ka edhe shumë raste të tjera specifike me emër e mbiemër, si veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kategoritë tjera sociale në atë rajon që janë në gjendje jashtëzakonisht të vështirë.

Vite të tëra pas luftës ka munguar gatishmëria institucionale për projekte dhe investime në atë rajon, edhe pse ishte tërësisht i shkatërruar, e dimë të gjithë këtë.

Realizimi i disa projekteve që ishin të domosdoshme në 3-4 vjetët e fundit, lëre se nuk gjetën përkrahje e përshtetje nga një pjesë e politikës në vendin tonë, por ato u kundërshtuan në çdo mënyrë.

Kolegët e zotit Eqrem Kryeziu, nga partia e tij në këtë Parlament, vazhdimisht kanë dhënë vërejtje ekstreme dhe të pabaza se gjoja po investohet shumë në rajone të caktuara, pa qenë të interesuar dhe pa dashur të dinë se cila është e vërteta në terren dhe cili është niveli i mirëqenies së atyre qytetarëve në raport me pjesën tjetër të vendit.

Le të bëhen edhe barsoleta, s'ka gjë të keqe, sepse qeshim nga ato, por duhet vazhduar investimet edhe me trendë më të mëdhenj në atë rajon të goditur pamëshirshëm nga rrjedha kohore, e që nuk është i vetmi në Republikën e Kosovës dhe jemi plotësisht i vetëdijshëm për këtë. Mirë do ishte të veprojmë duke na udhëhequr arsyeja. Në këtë rast dua të besoj singlerisht se zoti Eqrem Kryeziu i ka dhënë shenjat e para, duke reflektuar për të mirë e duke treguar edhe tolerancë, pasi e shoh që ulet edhe në rendin e fundit të deputetëve të partisë së tij. Falemnderit!

KRYETARI: E përfunduam pikën e parë të rendit të ditës, deklaratimet jashtë rendit të ditës. Ministri Fehmi Mujota e ka fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Falemnderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Deputetja Musliu e ka adresuar një çështje konkrete për projektin e Polacit, përkatësisht për rrugën që ka filluar diku rreth 7 vjet më herët dhe nuk është përfunduar ende.

Unë e kam dhënë një zotim publik, e nderuara deputete, para jush dhe para qytetarëve të Republikës së Kosovës, po natyrisht edhe para qytetarëve të Polacit, në mënyrë të veçantë, se projekti do të përfundojë këtë vit. Dhe, ne i kemi marrë masat konkrete për këtë gjë, shpronësimi që ka qenë problem në një pjesë të fshatit tani është përfunduar, i kemi bërë hapat e parë që të rifillojmë me pjesën e mbetur të projektit për një fazë, ndërsa për fazën e dytë ose finale po e bëjmë projektimin, sepse kërkohet një buxhet shtesë. Mbetemi pranë zotimit publik se projekti përfundimisht do të përfundojë dhe presim që Komuna dhe banorët të jenë bashkëpunues që problemet tjera, që i kanë ende të pazgjidhura, të mos i ngatërrojnë me rrugën kryesore, por të mbetet një pjesë e zgjidhjes së çështjeve tjera të rrugëve lokale në të ardhmen, në bashkëpunim me Komunën e banorët dhe natyrisht edhe Ministria do ta japë kontributin e vet. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Agim Çeku.

Deputet e ke fjalën.

DAUT HARADINAJ: Falemnderit, kryetar!

I nderuar zoti ministër Çeku,

Me qenë se jemi në përfundim të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, pyetja ime është: Deri ku ka shkuar procesi i transformimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës në ushtri të Republikës së Kosovës?

KRYETARI: Ministër Çeku, e ke fjalën.

MINISTRI AGIM ÇEKU: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Haradinaj,

Falemnderit për pyetjen!

Evoluimi i Forcave të Sigurisë së Kosovës në ushtri konvencionale të Kosovës është një ndër objektivat e Qeverisë, por kuptohet edhe i Ministrisë për Forcën e Sigurisë, në këtë mandat qeverisës.

Por, të gjithë e dimë që në bazë të Ligjit për FSK-në, i cili buron nga pakoja e Ahtisarit, FSK-së i janë dhënë shumë kufizime dhe këto kufizime nuk mund të rishikohen apo të ndryshohen para 5 vjetëve, që ligji është në fuqi, pra para qershorit të vitit të ardhshëm. Këto kufizime janë duke filluar nga emri, struktura, misionet, detyrat, numri i pjesëtarëve aktivë rezervë, e tjerë e tjerë.

Por, Qeveria nuk është duke e pritur qershorin e vitit të ardhshëm për ta rishikuar FSK-në, por me vendimin e 21 marsit të këtij viti, Qeveria ka marrë vendim që të rishikohet, jo vetëm FSK-ja, por i tërë sektori i sigurisë në Republikën e Kosovës.

Me këtë vendim, janë definuar: qëllimet, struktura e procesit, fazat dhe afatet kohore të këtij procesi.

Qëllimi i këtij procesi është që në fokus të rishikimit është FSK-ja, por të shfrytëzohet ky moment dhe të bëhet rishikimi i tërë sektorit të sigurisë, apo i tërë arkitekturës së sigurisë në Kosovë, me qëllim që të nxirret një strategji e re e sigurisë kombëtare në Kosovë dhe të definohet e tërë arkitektura e sigurisë në Kosovë, e cila do të garantojë pesë gjera.

E para, ushtrimin e sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës,

E dyta, mbrojtja e pavarësisë dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës,

E treta, mbrojtja e jetës dhe pronës së gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës,

E katërta, anëtarësimi i Republikës së Kosovës në të gjitha strukturat ndërkombëtare, apo organizatat ndërkombëtare të sigurisë,

Dhe e pesta, shndërrimi i Kosovës nga konsumuesi i sigurisë, në kontribuues të sigurisë.

Ky, pra, është qëllim i këtij procesi.

Është ndërtuar struktura, ky proces do ta ketë një komitet drejtues, të përbërë nga ministra përkatës, që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë, nga drejtorët e institucioneve apo agjencive të ndryshme të sigurisë, pjesëtarët e Parlamentit, është kryetari i Komisionit Mbikëqyrës të FSK-së dhe gjithashtu edhe Presidenca, me këshilltarin e vet për siguri

kombëtare, është e përfshirë në komitetet drejtues. Rastësisht, unë jam kryesues i këtij komiteti drejtues.

Është caktuar sekretariati i këtij procesi, që është Sekretariati i Këshillit Nacional të Sigurisë. Janë formuar disa grupe punuese, në radhë të parë grupi punues ndërmintor dhe çdo ministri përkatës i ka disa grupe punuese. Për shembull, Ministria e FSK-së i ka formuar 6 grupe punuese në këtë proces.

Janë definuar fazat, procesi do të ketë nën-faza. E para është vendosja e strukturës, caktimi i personelit që do të merret me këtë proces dhe trajnimi i tyre, e kjo fazë ka përfunduar plotësisht.

Tani jemi në fazën e dytë, jemi duke i definuar interesat kombëtare, duke i definuar politikat e mbrojtjes dhe të sigurisë, duke e definuar kontekstin strategjik të sigurisë në Kosovës dhe duke i definuar kërcënimet dhe rreziqet e mundshme për sigurinë e Kosovës dhe duke...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Deputet, a ke pyetje shtesë?

DAUT HARADINAJ: Zoti ministër, edhe sa oficerë të lartë do të largohen prej FSK-së derisa ajo të transformohet në ushtri?

KRYETARI: Ministër, vazhdoje!

MINISTRI AGIM ÇEKU: Do të vazhdoj të përgjigjem aty ku mbeta.

Thashë, duhet të them që mbi fazën e dytë, afatet kohore të përcaktuara duhet të përfundojnë në qershor të vitit të ardhshëm, dhe faza e fundit është adaptimi i legjislacionit të ri për tërë arkitekturën e sigurisë.

Duhet të them se edhe këtë në këtë proces e kemi mbështetjen e plotë të partnerëve tanë ndërkombëtarë, sidomos të SHBA-ve dhe NATO-s, Departamenti i Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara të Amerikës e ka formuar një ekip të veçantë, i cili dy herë ka qenë këtu, vjen çdo 6 javë, qëndron këtu për disa ditë apo javë me ne, dhe jemi në këtë proces të përbashkët.

Ekipi i këshilltarëve të NATO-s është i përfshirë në çdo grup punues, kështu që nuk jemi vetëm në këtë, e kemi mbështetjen e plotë, dhe do t'ia dalim.

Transformimi i FSK-së nuk ka të bëjë me largimin, por ka të bëjë me rekrutimin e njerëzve të rinj në numër edhe më të madh, por jo me largim.

KRYETARI: Falemnderit! Deputetja Xhevahire Izmaqi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Ministri nuk është këtu. Do ta bësh pyetjen deputete?

XHEVAHIRE IZMAKU: Mirë, nëse është e mundur, unë do ta kisha shtruar problemin.

KRYETARI: Urdhëro, shtroje pyetjen.

XHEVAHIRE IZMAKU: Qendrat për punë sociale, të menaxhuara më parë nga ministritë, tani menaxhohen nga komunat. Nga buxheti aktual nuk po mund t'i përballojnë shpenzimet që kanë në nivelet lokale dhe në këtë drejtim edhe Komuna e Vushtrrisë, si një komunë me gjendje të vështirë në aspektin social, posaçërisht te rasti i strehimit të personave të pastrehë, e ka një gjendje shumë të vështirë, të trashëguar me dekada. Për një kategori të qytetarëve në varfëri të skajshme, përjashtuar në këtë rast familjarët e dëshmorëve, për të cilët nuk dua të shtroj pyetje, pasi nuk dua t'i përfshij në këtë pyetje parlamentare.

Pyetja ime do të ishte: A ekziston një plan ose projekt me një nismë të tillë për ndërtimin e së paku një qendre sociale për rastet me varfëri të skajshme për komunën e Vushtrrisë, pasi është ndoshta ndër të vetmet komuna që nuk e ka përfituar një qendër të tillë për banim social? Pra, Komuna e Vushtrrisë dy vjet me radhë ndan nga buxheti i vet 150 mijë euro për ndihmë disa familjeve, që pjesërisht fillojnë të bëjnë së paku një dhomë e një banjë për familjet e tyre. Pyetja ime do të ishte: Nëse ekziston pra një plan i tillë, që së paku të ketë një qendër sociale për komunën e Vushtrrisë, siç ka edhe në komunat tjera, pasi pas luftës është e vetmja komunë që nuk e ka përfituar një të tillë. Ju falënderoj, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Thaçi. Teuta, a do ta parashtrosh pyetjen?

TEUTA HAXHIU: Thashë, po e pres kryeministrin për seancën tjetër kryetar. Falemnderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Kimete Bytyçi, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Deputetja nuk është këtu.

Vazhdojmë. Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Mujota. Deputet e ke fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

I posle veoma ozbiljnih zamerki i upozorenja, koje su Skupštini izneli poslanici srpske nacionalnosti zbog saobraćajnih i putokazni znakova, koji su prefarbani crnom bojom na srpskom jeziku, a na nekim mestima su i promenjena imena, u mnogim slučajevima su natpisi, ako nisu prefarbani, pravopisno su loše napisani, tako da su isto nerazumljiva i menjaju formu imena mesta.

Pitanje: Kada će Ministarstvo pokrenuti inicijativu kako bi se greške na saobraćajnim i putokaznim znakovima ispravili i zamenili novim znakovima koje oslikavaju multietnički, multijezički karakter sredine u kojoj se nalazi?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuari kryetar,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Marinković,

Mbishkrimet e vendbanimeve në tabelat informuese, si në vendbanime, në udhëkryqe, në udhëtregues, në informata turistike, në parqe nacionale e tjerë, të komunikacionit në rrugët publike, si autostradë, rrugë nacionale dhe regjionale, bëhen sipas projektit të sinjalizimit nga kompanitë projektuese, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Ngjyrosja dhe mbulimi me ngjyrë të zezë i tabelave informuese në vendbanime, tabelave treguese, drejtimeve të rrugëve, udhëtreguesve e të tjerë, bëhet nga persona të përgjegjshëm dhe për këto raste është njoftuar në vazhdimësi Policia e Republikës së Kosovës, e cila dhe i heton këto raste.

Tabelat, për informimin tuaj dhe të publikut, dëmtohen në të gjitha gjuhët dhe në të gjitha pjesët e vendit, nuk është vetëm një pjesë e caktuar, ose vetëm një nacionalitet, ose gjuha e një nacionaliteti e sulmuar.

Ministria e Infrastrukturës për çdo vit ndan mjete për sinjalizim sipas planit vjetor, ndërkohë po përpiqemi që bashkë me Policinë e komunikacionit, inspektoratin e ministrisë dhe inspektoratet komunale t'i parandalojnë këto dëmtime që ndodhin jo rrallë herë.

Lidhur me këtë kërkohet përkushtim edhe më i madh i të gjithë neve, përfshirë institucionet lokale, institucionet qendrore, por edhe shoqërinë civile dhe mediet për një vetëdijesim më të madh, që të mos dëmtohen tabelat dhe shenjat njoftuese.

Ju siguroj se përkushtimi ynë për ta zbatuar Kushtetutën dhe Ligjin lidhur me përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës do të jetë i plotë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet Marinković, a ke pyetje shtesë?

GORAN MARINKOVIĆ: Da, imam.

Pošto imamo toliko, kao što sam rekao, pravopisnih grešaka na putokaznim i znakovima koji oslikavaju imena mesta, možete nam reći koliko Srba radi na takvim mestima koji bi mogli pravopismo da ispišu imena mesta koje vidimo da su evidentna sad u ovom trenutku?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit! Ministria e Infrastrukturës e bën punën e vet mbi baza ditore dhe i ka ekipet e veta profesionale për mbikëqyrje, përkatësisht për mirëmbajtjen e të gjitha shënimeve në tabelat dhe në udhë drejtueset. Por, natyrisht që Qeveria e Republikës së Kosovës e ka Komisionin Ndërqeveritar për Gjuhën, në të cilën

të gjithë përfaqësuesit e nacionaliteteve mund ta japin kontributin e tyre dhe ne e mirëpresim. Natyrisht se gabime drejtshkrimore ka gjithandej nëpër Kosovë në shumë vende dhe të tilla ka edhe në këto tabela dhe, siç thuhet, në të gjitha shenjat e komunikacionit, dhe ne do t'i ndërmarrim masat tona si ministri. Presim bashkëpunim edhe nga autoritetet komunale, edhe deputetët edhe të tjerët që ta japin kontributin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Dhe, me këtë e kemi përfunduar edhe pikën e dytë të rendit të ditës.

Deputetët që nuk kanë marrë përgjigje në dy seanca në pyetjet e parashtruara, pyetjet do të publikohen në revistën e Kuvendit, sipas nenit 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Unë po i ftoj deputetët që të kthehen në sallë, sepse po kalojmë në pikën e tretë.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 31 maj 2012

Më duhet ta them një vërejtje sipas elektronikës. Të pranishëm janë 83 deputetë, dhe unë ju kisha lutur që, përveç deputetëve që janë të pranishëm, kartelat tjera të hiqen nga aparatet përkatëse. Do të thotë, të hiqen kartelat e deputetëve që nuk kanë ardhur sot në seancë. Kur të vijmë, e vendosin. Le ta marrin kartelën me vete, sepse, siç e dini, nganjëherë deputetët nuk vijnë fare, ndërkaq kolegët e tyre e vendosin kartelën.

Seancën nuk mund ta vazhdojmë pa praninë e kuorumit, prandaj 10 minuta pauzë.

(Pauzë)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë.
Të pranishëm janë 72 deputetë.

Kërkoj nga deputetët që të kenë respekt më shumë për ulëset në Parlament.

Fillojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 31 maj 2012

A ka vërejtje në procesverbalin në fjalë? Nuk ka. Konsideroj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 31 maj 2012.

Para se të vazhdojmë me rendin e ditës, fjalën e ka kërkuar deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,
Zoti nënkryetar,
Kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së kërkojmë lidhur me rendin e ditës, që pika e tetë, që ka të bëjë me shqyrtimin e Raportit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të shtyhet derisa nuk e kemi edhe Raportin e auditimit, i cili në mënyrë më detale to të na jep performancën dhe natyrisht, punën e asaj agjencie e që rrjedh edhe nga rekomandimi i vitit të kaluar si Kuvend, që ta kemi edhe raportin e auditimit. Falemnderit!

KRYETARI: Le të deklarohej kryetari i Komisionit, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, zoti kryetar!

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në mbledhjen e vet e ka trajtuar këtë raport. Ka qenë një debat brenda Komisionit, për cilësinë e raportit. Brenda raportit, përveç që janë pasqyruar aktivitetet e kësaj agjencie, që konsiderohen në një progres më pozitiv se sa në periudhën e kaluar, është po ashtu edhe një raport financiar.

Kështu që komisioni e ka dhënë dritën e gjelbër dhe e ka bërë rekomandimin, që në seancën e sotme të aprovohet ose të trajtohet. Falemnderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, a e do fjalën? Deputeti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, kryetar!

Edhe në Grupin Parlamentar e kemi diskutuar këtë raport. Kemi vlerësuar dhe jemi pajtuar me vlerësimin që ka dhënë komisioni. Mendojmë se ky raport është i kompletuar dhe mund të votohet dhe të kalojë.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosjes”, kryetari i Grupit, deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Sa i përket Raportit të AKP-së, pra nuk mund të themi se është i kompletuar, meqenëse pasqyrat financiare duhet të auditohen. Auditimi nënkupton një lloj mbikëqyrje dhe vlerësimi të pavarur për pasqyrat financiare, të cilat i deklaron agjencia. Natyrisht, që agjencia do t'i deklarojë pasqyrat financiare të mira dhe raportin në përgjithësi të mirë. Mirëpo, auditimi na tregon neve si deputetë, nëse qëndron vërtetësia e pasqyrave financiare në raportin e paraqitur.

Rrjedhimisht, pa këtë unë e konsideroj, që raporti nuk mund të quhet i kompletuar.

Në anën tjetër, meqenëse po flasim për një agjenci e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe që ka një impakt jashtëzakonisht, për mendimin tim të dëmshëm në ekonominë e Kosovës, ky raport ishte dashur të trajtohet në seancë në mënyrë më të kujdesshme dhe rrjedhimisht, konsiderojmë që për një çështje të tillë duhet t'i kemi edhe përfaqësuesit e agjencisë këtu, në mënyrë që deputetët të kenë mundësinë, që t'u shtrojnë atyre pyetje dhe të marrin përgjigje dhe shpjegime nga ata, për ato që shkruhet në raport.

Kush e ka lexuar raportin e ka parë që është goxha sipërfaqësor dhe është jashtëzakonisht teknik dhe nuk e tregon tërë atë që flitet për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe krejt punën e kësaj agjencie, përgjatë vitit 2011 po edhe viteve paraprake.

Kështu që, ne pajtohemi me mocionin e ngritur nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike dhe po ashtu, e shtojmë edhe këtë kërkesë tonën, që kur ta diskutojmë raportin, të ftohen edhe përfaqësues të agjencisë, që të jenë pjesëmarrës në seancë. Falemnderit!

KRYETARI: Ju e dini, që në seancë nuk shtrohen pyetje dhe unë po kërkoj, ashtu siç është me ligj, ligji të respektohet, Nëse vlen për të gjitha agjencitë, që i përgjigjen Kuvendit, pritet dhe raporti i auditimit, le të pritet, por nëse kjo nuk është praktikuar me agjenci tjera, unë nuk jam që të bëjmë diskriminime ose dallime ndërmjet raporteve të agjencive dhe të komisioneve, që i përgjigjen Kuvendit. Do të thotë, kjo çështje është e paraparë me ligj dhe ne jemi të obliguar që ta mbrojmë ligjin.

Tjetër, përfaqësuesit e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si po quhet, s'e di cila është gjuhësisht më drejtë, realisht është obligimi i komisioneve parlamentare t'i pyesin. Nuk di sa është..., ne seanca t'i marrim në pyetje ata!

Vazhdojmë. Fjalën e ka kryetari i Grupit të Aleancës, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Është e vërtetë se nuk është praktikë, që para shqyrtimit të raporteve t'i kemi raportet e auditorit.

Sidoqoftë, duhet të pajtohemi se një gjë e tillë do të ndërtonte një praktikë të mirë, nëse do ta vendosnim në Kosovë.

Mendoj se mocioni do të hidhet në votë. Nuk e kemi praktikë, por ndoshta edhe praktikat mund të vendosen, që të kemi raport të auditorit. Nëse një gjë e tillë nuk do të ndodhë sot, atëherë detyrimisht Kuvendi duhet që në momentin që e merr raportin e auditorit, të diskutojë edhe për atë raport, në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Falemnderit!

KRYETARI: Unë mendoj, që kur të vijnë raportet e auditimit, përsëri çështja mund të shtrohet në debat.

Fjalën e ka, në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe deputetët!

Duke marrë parasysh raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në efekt ajo është një përkthim i punës, të cilën Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka bërë gjatë vitit 2011,

mirëpo edhe në bazë të ligjit, AKP-ja është formuar nga Kuvendi i Kosovës dhe jep pasqyrë negative të bizneset vendore dhe bizneset ndërkombëtare.

Kështu, në rast se e shohim raportin si raport, ai është një përshkrim. Dhe, në rast se duam të gjitha këto deklaramë, të cilat bëhen nga përfaqësuesit e AKP-së dhe bizneseve vendore dhe ndërkombëtare, në lidhje me çështjen e investimeve në AKP dhe në Kosovë, atëherë detajizimi i këtyre deklaramëve do të ndodhë kur të vijë raporti i auditimit, për arsye se ne nuk jemi gjykatës, ne jemi ligjvënës.

Dhe, mundësia më e mirë është që të kemi një raport të auditimit dhe të shohim, në efekt a është e gjithë puna e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ashtu siç deklaroi bordi i saj, apo Agjencia Kosovare e Privatizimit po vazhdon me avazin e vjetër, si AKM-ja? Ju falemnderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti i SLS-së, Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!
Poslanička Grupa Samostalne Liberalne Stranke smatra da danas treba da razmatramo izveštaj Kosovske Agencije za Privatizaciju. Hvala!

KRYETARI: Falemnderit!

Në emër të Grupit “6+”, deputeti Albert Kinolli. E ka fjalën kryetari i Grupit.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit!

I nderuar kryetar,
Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah rekomandimin e komisionit dhe është pro shqyrtimit të këtij raporti të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Edhe ty Armend po ta japim fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, falemnderit!

Ne e kemi potencuar edhe ditë më parë, në raporte tjera që duhet të ndryshojë forma e raportimit të raporteve të agjencive që janë të pavarura dhe ato sigurisht, edhe këto që janë themeluar nga Kuvendi.

Është mendim imi personal, pavarësisht se është shumë e qartë se që të jetë një raport i kompletuar, duhet t'i përmbajë edhe këto elemente:

- Një raport për vlerësimin e punës,
- Rekomandimin,
- Raportet e auditorit gjeneral dhe të financave.

Por, ne tash në këtë moment gjendemi para një ligji dhe Rregullores së Kuvendit, që për momentin jemi të kufizuar që t'i trajtojmë kështu siç janë.

Ne me Rregulloren e re duhet t'i parashohim që këto elemente duhet të futen apo në rekomandimet e Kuvendit, të shkojë edhe në ndryshim të legjislacionit, për shqyrtimin e raporteve të agjencive të pavarura.

Kjo është një sqarim, momentalisht, raportet i trajtojmë sipas legjislacionit dhe Rregullores që është në fuqi.

KRYETARI: Pra, sipas legjislacionit dhe Rregullores, raportet e agjencive miratohen në Kuvend, ashtu siç vijnë dhe nuk lidhen me Raportin e Agjencisë tjetër.

Agjencia e Auditimit është e veçantë dhe trajtohet veçanërisht. Për shembull, me Rregulloren, me rregullën 72, procedurat e veçanta për raportet e organeve të pavarura, në paragrafin 2 shkruan: "Komisioni duhet ta shqyrtojë raportin vjetor të organit të pavarur dhe t'i paraqesë Kuvendit raport me rekomandime, brenda 3 javësh pune nga data që e kanë marrë."

Kështu shkruan në Rregulloren e punës së Kuvendit, mbi bazën e të cilës ne punojmë.

Megjithatë, e kemi një mocion dhe, unë mocionin e qes... Fjalën e ka, në emër të Komisionit të Kontrollit Financiar, kryetari i tij, deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Unë dua t'ua përkujtoj juve dhe deputetëve tjerë se vitin e kaluar kur është shqyrtuar raporti i audituar nga Zyra e Auditorit Gjeneral, ku ndër konstatimet kryesore, thelbësore të atij raporti, kanë qenë se ai nuk mund të japë opinion, derisa nuk ka një auditim të performancës.

Rekomandim i Komisionit për Zyrën dhe i njëjti rekomandim ka kaluar edhe në Kuvend, ku i është dhënë detyrë Zyrës së Auditorit Gjeneral, që ta bëjë një raport të performancës. Flas për vitin e kaluar, prandaj kërkesa që të presim deri në raportin, është në harmoni me vendimet tona. S'kemi nevojë me i këqyr ne ato tjerat. Vendimi ynë ka qenë. Kërkojmë një raport të performancës, për veprimet që ka bërë në vitin 2010. Dhe, do të na hapin refleksionet edhe për vitin 2011 tash, se jemi, edhe atë raport ai sigurisht e ka të gatshëm.

Prandaj, unë nuk e shoh të arsyeshme që të ngutemi, ta presim edhe tjetrin dhe do të bisedojmë me kompetencë dhe në harmoni me vendimin tonë, të mos i shkelim vendimet tona.

Nuk po bëjmë precedencë. Ne ia bëmë kështu edhe RTK-së dhe kemi bërë shumë mirë. Fill mbas atij konstatimi, ata kanë ardhur në komision dhe kanë kërkuar sqarime çka duhet të ndërmarrin për t' i tejkaluar ato rekomandime. Të njëjtën gjë mund ta bëjmë edhe me këta. Domethënë, ne po kërkojmë ta sqarojmë çka ka aty.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ne mund të marrim një vendim, se varet nga votat tuaja, megjithatë, këto gjëra janë të përcaktuara shumë qartë edhe në ligje edhe në Rregulloren e Kuvendit.

Unë s'e kam ndërmend të mbrojë asgjë, por nëse vendosim një praktikë ajo duhet të vlejë për të gjitha raportet e agjencive dhe të komisioneve të pavarura që ato raporte, të gjitha këtyre agjencive dhe komisioneve të pavarura të mos miratohen pa pasur edhe raportin e auditimit të përgjithshëm. Dhe, unë konsideroj që kjo shkakton vështirësi për punën e Kuvendit.

Megjithatë, vendimmarrja është e Kuvendit dhe unë jam i obliguar që mocionin ta hedh në votim. Jo, s'kemi çka të bëjmë, vendos vota e deputetëve dhe unë nuk do të vazhdoja më shumë me debat.

Të pranishëm i kemi 78 deputetë dhe e votojmë mocionin e kërkuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, nga deputeti Lutfi Zharku.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Me 35 vota për, 37 kundër, 3... S'ka nevojë! Nuk...

(Ndërhyrje)

Të pranishëm janë 78 deputetë. Regjia, nënkryetari po thotë s'janë 78 deputetë. Ju lutem numërojeni deputetët. Me kartela, të pranishëm janë 80, po ne e dimë që ka kartela më shumë.

Prania fizike po më duhet, s'po më duhet kush ka kartelë e kush s'ka. Deputetët le t'i mbajnë kartelat me vete. Unë e dua praninë.

Të pranishëm janë 75 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Miratimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, lidhur me rolin dhe pozitën e fëmijëve në Kosovë

Po kërkoj nga grupet parlamentare, a i keni harmonizuar rekomandimet? Po. Ku është kryetarja e Komisionit?

Ftoj deputeten Suzan Novobërdaliu, kryetare e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, që para Kuvendit të paraqesë tekstin e rekomandimeve të harmonizuara.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Falemnderit, kryetar!

Unë dëshiroj të theksoj se rekomandimet e propozuara më 1 qershor, ngelin të njëjta, do të thotë, janë 7 rekomandime, të cilat i kam lexuar më 1 qershor. Kemi një rekomandim të ri, i cili është paraqitur nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe është ky - të hartohet Ligji për të drejtat e fëmijëve. Do të thotë, tani i kemi 8 rekomandime dhe i lus deputetët, që të njëjtat t'i votojnë. Kryetar, a t'i lexoj shtatë rekomandimet përsëri.

KRYETARI: Po, lexoj të shtatë rekomandimet, se pastaj po thonë s'po dimë çka po votojmë.

SUZAN NOVOBËRDALIU: I keni të gjitha.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, në afat sa më të shkurtër kohor, të hartojë programin kombëtar gjithëpërfshirës për zhvillimin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme, i cili do të garantojë zhvillimin e plotë të fëmijës, si një qytetar i dobishëm dhe produktiv për shoqërinë kosovare.
2. T'i inkurajojë institucionet, si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel lokal, duke siguruar burime njerëzore dhe financiare, të nevojshme për zbatimin e politikave të nevojshme në hartimin, zbatimin, mbikëqyrjen, lidhur me edukimin në fëmijërinë e hershme në Kosovë.
3. Të hartojë programe cilësore dhe edukative për prindërit, me qëllim të përmirësimit të ushqyeshmërisë, kujdesit dhe stimulimit të nxënies në fëmijërinë e hershme, që do t'u ofrohen nëpërmjet shërbimeve shëndetësore, si maternitetet dhe qendra të mjekësisë familjare, në sektorin publik dhe privat, në bashkëpunim me sektorin e arsimit dhe mirëqenies sociale.
4. Me qëllim të realizimit të drejtave të fëmijëve për zhvillimin e potencialit të plotë kognitiv, emocional, social, fizik dhe përgatitjen e nevojshme paraprake për shkollë, të hartojë programe edukative, cilësore për prindër, edukatorë dhe kujdestarë, nëpërmjet shërbimeve, që do t'u ofrohen nga institucionet e arsimit, në bashkëpunim me institucionet e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.
5. T'i fuqizojë shërbimet sociale për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës, keqtrajtimit dhe eksploatimit si dhe mbrojtja sociale, nëpërmjet ofrimit të asistencës sociale për fëmijët në nevojë.
6. Ta fuqizojë zbatimin e kodeve etike nga të gjitha institucionet dhe profesionistët, të cilët punojnë drejtpërdrejt me fëmijë, si dhe mediet, për të siguruar mbrojtjen nga cenimi i të drejtave të fëmijëve.
7. Të sigurojë që në procesin e riadhesimit, në mënyrë individuale të shqyrtojë çdo rast duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës, në mënyrë që të kenë qasje të barabartë në shërbime shëndetësore, arsimore dhe sociale.
8. Të hartohet Ligji për të drejtat e fëmijëve.

Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ka nevojë të shkojmë me shefat. Po mendoj që po shkojmë në procedurën e votimit. Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash, raportin me rekomandime.

Të pranishëm janë 74 deputetë. Votojmë tash.

Me 67 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur, Peticione lidhur me pozitën e fëmijëve në Kosovë.

Unë kisha kërkuar një votim formal, që ta bëjmë ndërrimin e dy pikave të rendit të ditës, pikës 5 dhe pikës 6. Në pikën 6 kemi- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për persona të verbër dhe personat pjesërisht të verbër. Pasi i kemi këtu të pranishme edhe Shoqatën dhe përfaqësuesit e tyre, kisha kaluar me një votim formal.

Kush është për këtë ndërrim? Faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për persona të verbër dhe personat pjesërisht të verbër

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputeten Suzan Novobërdaliu, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Falemnderit, kryetar!

Komisioni në disa mbledhje të mbajtura e ka shqyrtuar projektligjin, i cili i ka ardhur Parlamentit dhe pastaj komisionit tonë.

Në të njëjtin kemi bërë disa ndryshime, disa amendamente i kemi bërë dhe mendoj se tani është një ligj më i mirë. Dhe, lus deputetët që këto rekomandime të komisionit, të cilin e drejtoj, t'i votojnë. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: ...Gjithsej 25 amendamente. Amendamenti 22 është pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kështu që, ne po fillojmë me amendamentin e parë.

Votojmë tash!

A ka kundër për amendamentin e parë?
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 2
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 3
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 4
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 5
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 6.
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 7
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 8
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 9
 Kundër? S'ka.
 Abstenim? S'ka.
 Miratohet.

Më falni, këtu i kemi dy propozime, propozimi i parë është i Komisionit FunkSIONAL dhe propozimi i dytë i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit

Funksional. Ne sipas radhës, s'di sa është e arsyeshme, por megjithatë po ua japim fjalën deputetëve. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit Funksional, Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Falemnderit, kryetar!

Ne si komision, siç thashë edhe më herët, e kemi shqyrtuar këtë projektligj. Në këtë nen kemi pasur ndryshim, nuk e kemi përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ne kemi dalë me një propozim prej, kemi thënë një kompensim t'iu ndahet personave të verbër, në lartësi prej 40% të pagës mesatare, në Kosovë. Por, meqë momentalisht nuk kemi të përcaktuar pagën mesatare, komisioni është pak vështirë të përcaktohet. Komisioni ka ndërruar qëndrim dhe tani del me propozim 70% të pagës minimale, në Kosovë. Do të thotë, prej lartësisë 170 euro, këtyre u bie, kësaj kategorie të shoqërisë i bie 127 euro t' i marrë, derisa propozimi i Komisionit për Buxhet është 100 euro. Do të thotë, jo me pak se 100 euro të jetë kompensimi, që konsiderojmë që nuk ka bazë ligjore dhe shumica e shteteve të Evropës dhe të botës e kanë të përcaktuar, do të thotë, pagesën e lartësisë, kompensimit, për shkak të verbërisë në përqindje.

Prandaj, i lus deputetët që ta përkrahin propozimin e Komisionit Funksional. Falemnderit, kryetar!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Vërtet është shumë e vështirë edhe të japish propozime edhe të marrish vendime, kur është çështja tek personat të cilët kanë aftësi të kufizuar dhe mua më vjen keq, që në disa raste, ndoshta, po përpiqemi t'u bëjmë mirë dhe në fakt nuk po u bëjmë mirë, sepse janë disa rregulla të cilat janë të përcaktuara, kurse disa nuk janë të përcaktuara.

Nëse ne shkojmë, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka diskutuar shumë seriozisht çështjen e përcaktimit të kompensimit për personat me verbëri. Ne kemi pasur debate dhe diskutime nga më të ndryshmet në komision dhe e kemi shqyrtuar me shumë kujdes edhe amendamentet e Komisionit Funksional dhe kemi ardhur në përfundim, kemi angazhuar edhe ekspertë të fushës së caktuar, që njohin mirë ligjet dhe kemi ardhur në përfundim, që meqenëse nuk ka ndonjë dokument, ndonjë vendim, diçka që përcakton saktësisht pagën mesatare, atëherë ne do t'i vëmë në lajthitje personat e verbër, për arsye sepse nuk ka bazë ku të llogaritet paga apo kompensimi për këtë kategori.

Kurse, edhe në ligjin që ka qenë i propozuar nga Qeveria ka thënë që kompensimi indeksohet në rritjen e pagës minimale. Dhe, për pagën minimale, me aktin nënligjor, që nxirret nga Qeveria përcaktohet paga minimale, në bazë të propozimit, të cilin e jep Këshilli Ekonomik Social. Dhe, sipas këtij vendimi të Qeverisë të vitit 2011, që është në fuqi, paga minimale për persona deri në 30 vjet është 130 euro, ndërsa përmbi 35 vjet deri në 65, është 170 euro.

Komisioni për Buxhet, po ju them, unanimisht ka ardhur në përfundim, që indeksimi i pagave të tyre të bëhet në bazë të rritjes apo rritjes së pagës minimale. Mirëpo, kur është

çështja të kalkulimi, meqenëse ka pagë minimale edhe 130 euro dhe me përqindje mund të bie edhe më ulët se sa 100 euro, Komisioni për Buxhet unanimisht ka vendosur, që kompensimi të mos jetë më i vogël se sa 100 euro. Jo më pak se 100 euro, kurse sipas lëvizjes së pagës minimale, të lëvizë edhe paga e tyre.

Unë dua ta lexoj amendamentin që ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa me një plotësim në fund, që i indeksohet rritjes së pagës minimale.

Domethënë, neni 2 të jetë kështu: - Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga Buxheti shtetëror, jo pensionin siç është shkruar këtu, por kompensimin, domethënë, nga buxheti shtetëror kompensimin, në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pak se 100 euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria. Kompensimi indeksohet në rritjen e pagës minimale në Kosovë.

Ky është propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe unë ju kisha propozuar deputetëve ta miratojnë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe vërtet ta bëjnë të zbatueshëm këtë ligj për këtë kategori të ndjeshme të shoqërisë sonë.

KRYETARI: Në emër të LDK-së, Lutfi Haziri e ka kërkuar fjalën.

LUTFI HAZIRI: Jo në emër të Grupit Parlamentar, por si deputet, mendoj që përvojat në regjion dhe brenda shteteve të BE-së, sa i përket kësaj kategorie, duhet të merren pozitivisht.

Unë e di që kapacitetet buxhetore në Kosovë janë shumë të limituara, por 70% nga paga minimale është e përballueshme dhe duhet kësaj kategorie t' i japim mbështetje, sepse shumë kategori tjera në Kosovë janë akomoduar ose janë në proces të akomodimit, në kuptimin e mbështetjes shtetërore.

Kategori e cila ka kurajë dhe përkushtim, në veçanti shoqatat e të verbërve me angazhimin dhe problemet që i kanë, janë jashtëzakonisht shumë duke punuar. Këta përfaqësojnë gjithë kategorinë, sepse si kategori të ne kanë qenë të fshehur. Këto shoqata kanë bërë shumë, jashtëzakonisht shumë, për t' i zbuluar rastet dhe për t' i vendosur në tretman.

Janë kategori jashtëzakonisht e ndjeshme, për të cilën ne duhet të tregojmë kujdes të veçantë dhe mendoj, që një rishikim eventual, pas miratimit të këtij amendamenti, do të krijonte mundësi që të mos rëndohet shumë buxheti, por është realisht të mbështeten këta njerëz. Falemnderit shumë!

KRYETARI: Në emër të PDK-së, Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën.

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, kryetar!

Ne kemi të bëjmë me një kategori, vërtet tepër të ndjeshme.

Si shef i Grupit Parlamentar kam pasur takime me Shoqatën e të Verbërve. Kemi diskutuar gjerë e gjatë për problemet që i kanë dhe shqetësimet e tyre. Unë jam dakord me atë që thotë kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të mos të shkojmë nga ajo se duke i ndihmuar t'i mbysim krejt, por propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, për mua dhe për Grupin Parlamentar, është shumë më i arsyeshëm, sepse i garanton kësaj kategorie të ardhura, jo më pak se 100 euro, por nuk e përjashton mundësinë që ato të ardhura të shkojnë në rritje.

Nëse shkojmë në përqindje, në bazë të informacioneve të tjera, konsultat që janë bërë edhe me ekspertë, por edhe me institucione tjera ndërkombëtare, frikësohem se ne nuk do të kemi mundësi që ta zbatojmë këtë vendim.

Ndërsa, propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa e kanë pranuar edhe institucionet ndërkombëtare edhe ato shtetërore dhe kemi garanci se në mënyrë automatike ky vendim fillon të zbatohet. Por, gjithnjë duke përcjellë gjendjen e tyre materiale, me mundësi të rritjes së këtij kompensimi prej 100 eurosh, që mund të shkojë edhe 130 apo 140 euro e kështu me radhë.

Prandaj, unë i kisha lutur të gjithë deputetët që kur kemi parasysh këtë kategori, të jemi shumë të vëmendshëm, vërtet t'i ndihmojmë.

Ne tash para pak minutash kishim një takim me përfaqësues të tyre dhe së bashku me kryetaren, ne deri diku u dakorduam që propozimi i Komisionit për Buxhet të përkrahet nga të gjithë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosje”-s, deputetja Albana Gashi e ka kërkuar fjalën.

ALBANA GASHI: Falemnderit, kryetar!

Fillimisht dua të theksoj se nuk është e vërtetë ajo çka tha parafolësi, se Shoqata e të Verbërve është pajtuar me shumën që ka caktuar Komisioni për Buxhet dhe Financa. Pastaj, dua të potencoj faktin që qëndrimi i Lëvizjes “Vetëvendosje” fillimisht, ka qenë që të verbrit të marrin si pagë kompenzuese, për efekt verbërie 60% të pagës mesatare.

Në fillim edhe Shoqata u pat pajtuar me këtë përqindje, mirëpo Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka miratuar këtë amendament, me arsyetimin për mungesë buxheti dhe e ka kufizuar pagesën për efekt verbërie, në shumën prej 100 eurosh, bile e ka çekur atë se është pension.

Fillimisht, kjo shumë nuk është pension, por është pagë për efekt verbërie, sepse një fëmijë i cili lind i verbër ose më pas bëhet i verbër, nuk mund të kategorizohet me pensionist, pra nuk mund të shkojë automatikisht në pension.

Një gjë tjetër shqetësuese që dua të theksoj se gjatë tërë kohës sa ne kemi punuar në këtë ligj, të verbërve u është bërë presion: pranojeni këtë ose atë shumë, ose përndryshe do të mbeten pa hiç, siç u tha edhe pak më herët këtu.

Për fund, pasi që Shoqata e të Verbërve është pajtuar me shumën prej 75%, jo 70% të pagës minimale, atëherë Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë këtë propozim, pra propozimin e Komisionit FunkSIONAL për shumën prej 75%-ve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nuk e di çka keni ju përpara, por unë nuk e kam as 60, as 75, as 70, por 40%, prandaj, është mirë amendamentet t’i lexoni ashtu siç janë para jush. Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zotni kryetar,

Deputetë të nderuar,

Unë veç po shtoj pyetje shtesë nga ajo që bëri kryetari i Kuvendit, Krasniqi, sepse nuk di a i keni në dorë këto amendamente? Këto janë dy variante.

I pari thotë: marrin kompensim a quajeni si të doni, 40% të pagës mesatare. Pse s’po e përktheni në shifër edhe këtë, t’i dimë referencat? Nuk kemi nevojë të bëjmë mjegulli. Nëse, këndej po e afishojmë një njëqind euro, atëherë dy shefat e komisioneve le të më thonë mua dhe opinionit dhe të interesuarve këtu, qysh përkthehet 40% i mesatares, sa bën ajo?

Nëse përkthehet ajo dhe bëhet shifër dhe e kemi një 100 euro e shohim atë tjetrin çka është, mbasandaj bisedojmë, a është e mundur, e pamundur apo jo, sepse, këto përqindje që po përsëriten, ne s’kemi referencë? Pra, kemi të bëjmë, a të votojmë 40% të pagës mesatare, që bën kaq, apo referencë me 100 euro, që nuk është mesatarja, por është pak më pak se mesatarja.

Atëherë, tregoni mesatarja është kaq, ajo referencë mbasandaj shkon me përqindje të dyjave. Të bëhemi të qartë. Faleminderit! Kaq.

KRYETARI: Shikoni, ju lutem të mos hyjmë në debat... Jo, nuk do t’ia jap fjalën asnjë grupi parlamentar, përveç atyre që s’e kanë marrë fjalën asnjëherë. Keni qenë në komisione dhe është dashur atje t’i harmonizoni qëndrimet.

Për replikë është paraqitur Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, kryetar!

Për hir të korrektësisë edhe të opinionit, se asnjëherë në jetën time s’jam i mësuar, s’e lejoj veten të manipuloj me opinion, të përfitoj në emër të fatkeqësive të tjerëve, e aq më pak kur kemi të bëjmë me një kategori tepër të ndjeshme, tepër të respektuar.

Unë para pak minutash, i kemi prapa përfaqësuesit, edhe Bujari edhe Dauti janë, biseduam me ta dhe nëse llogarisim propozimin e komisionit 40%, ne këtë kategori do t’i dëmtojmë të paktën për 30 euro. Nëse shkojmë me propozimin e Komisionit për Buxhet, shihet se ne u sigurojmë një kompensim prej, në minimum 100 euro, duke mos e përjashtuar mundësinë që kjo rritje të jetë më e madhe deri në 130 euro, në bazë të disa parallogarive që janë bërë, por asnjëherë ne nuk guxojmë të shkojmë në përqindje se s’kemi një referencë të saktë, se ku duhet të mbështetemi.

Prandaj, të mos lejojmë të manipulojmë me këtë kategori,

KRYETARI: Nuk bën, sqarim, s'kemi çka të sqarojmë këtu. Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, kryetar!

Mendoj se njëfarë radhe është që të deklarohen grupet parlamentare, para se ta marrin fjalën të tjerët dhe do të ishte mirë ta respektojmë për shkak se po e humbim esencën e fjalës, jo për diçka tjetër.

Ne si grup parlamentar e mbështesim propozimin e Komisionit FunkSIONAL, edhe pse e kemi të qartë se mund të ketë dallime ndërmjet asaj që propozohet dhe vlerës së vërtetë.

Sidoqoftë, Komisioni FunkSIONAL për një kohë të gjatë ka diskutuar me Shoqatën e të Verbërve. Po ashtu, mendojmë se debati i sotëm, të paktën ndoshta do ta nisë një përkujdesje të shoqërisë së Kosovës, ndaj një kategorie shumë specifike, siç janë të verbrit, ose ata me pamje të kufizuar.

Mendojmë, se nëse sot e votojmë propozimin e Komisionit FunkSIONAL, do të mund të shohim shumë shpejtë se cilat do të jenë benefitet për këto kategori dhe shpejtë ndoshta, do të fillojmë të punojmë edhe në drejtime tjera, jo vetëm në kompensimin material. Për shembull, të verbrit më tregojnë mua se në një shkollë për të verbër në Pejë, më tepër se 40 personel punojnë për 20 nxënës, ndërsa ata nxënës duhet të udhëtojnë prej vendeve të largëta.

Domethënë, kemi shumë probleme me këtë kategori, nuk është vetëm kompensimi, ndërsa sot mendojmë se duhet ta votojmë zgjidhjen, e cila, të paktën u jep një siguri më të madhe financiare. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: ...Nuk do t'ia jap fjalën asnjë deputeti më, vetëm kryetarëve të komisioneve. Absolutisht u krye. Grupet parlamentare i kanë pasur deputetët në të dy komisionet. Ne e dëgjuam fjalën e kryetares së Komisionit për Buxhet dhe Financa, që tha në mënyrë anonime, ne e kemi bërë këtë. Prandaj, dëgjoni dhe mësohuni, që amendamentet që janë ndryshuar pasi janë dorëzuar, vetëm seanca mund të marrë vendim, më s'mund komisioni të marrë vendim. Këtu janë disa rregulla. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Kryetar, faleminderit, shumë!
Ka nevojë për një sqarim të vogël.

E vërtetë është që në duart e deputetëve e keni propozimin prej 40% të pagës mesatare, propozimin e komisionit, të cilin e drejtojnë unë.

Por, meqë momentalisht nuk kemi të përcaktuar pagën mesatare, ne si komision, sot jemi mbledhur, kemi marrë qëndrim, që të dalim me një propozim që të jetë kompensimi në lartësi prej 75% të pagës minimale në Kosovë, të vlerës 170 euro, do të thotë, 127,50 euro t' u takojë kompensim personave të verbër.

Ky është qëndrimi i sotëm dhe shumë me të drejtë e keni që...

KRYETARI: Jo, qëndrimi i sotshëm i juaji s' është i drejtë hiç...

SUZAN NOVOBËRDALIU: Qëndrimi i Komisionit...

KRYETARI: ...Ju lutem, nuk është i drejtë hiç, as në emër të komisionit.

Ju e dini, që përgjegjësinë për Buxhet dhe Financa, jo vetëm të kësaj natyre, por për gjithë Kosovën e ka Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ju nuk mund ta merrni një vendim, pa e konsultuar Komisionin për Buxhet dhe Financa. Nuk është mirë asnjë komision të mos i di detyrat dhe përgjegjësitë e veta, që i ka edhe me ligj edhe me Kushtetutë, por edhe me Rregullore të Kuvendit.

Në emër të Komisionit të Ligjeve, deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

Këtu po ndodh një tollovi shumë e madhe, sepse po merren dy referenca dhe tash, jam i bindur që shumica e deputetëve janë në lajthitje.

Po bëhen dy referenca, njëra thotë 40% e pagës mesatare, kur ne nuk e dimë se sa është paga mesatare në Kosovë, tjetra referencë thotë, 75% e pagës minimale, që është 170 euro, kështu që unë mendoj se do të ishte më mirë edhe për vendimmarrjen e Kuvendit, që të sqarohet kjo punë nga komisioni përkatës, të kalojë edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe pastaj, të vijë për seancë, sepse po shkaktohet një lajthitje dhe mund të merret një vendim i gabuar në seancë, duke pasur krejt vullnetin e mirë, që ta bëjmë më të mirën e mundshme për atë kategori sociale.

Kështu që të mos bëjmë një gabim pa nevojë. Nuk kemi nevojë të përplasemi, sepse nuk është një çështje politike, për të cilën ne duhet për t' u përplasur. Referencat janë të gabuara. Kaq kisha unë. Falemnderit!

KRYETARI: Edhe unë jam që ta heqim nga rendi i ditës. Komisionet të merren vesh dhe, po kërkoj jo vetëm nga këto dy komisione, por nga komisionet, që mos ta shndërrojnë Parlamentin në odë, se ka rend të ditës, ka rregullore, Kushtetutë dhe ligj. Dhe, ne nuk mund të bisedojmë mbi bazën e vullnetit të asnjë grupi parlamentar e as të një komisioni që nuk ka qenë i përgjegjshëm dhe nuk e di detyrat e veta që i ka me Rregullore Kuvendit.

Kthehemi në pikën e pestë të rendit të ditës. Komisionet le të merren vesh për këtë çështje.

5. Shqyrtimi i parë i projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit

Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj ministren e Tregtisë dhe të Industrisë, zonjën Mimoza Kusari-Lila, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Falemnderit, shumë!

I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projekt-legjislativi, t'i përmend shkurtimisht arsyet për hartimin e projektligjit të ri për mbrojtjen e konsumatorit, qëllimin, rëndësinë dhe rolin, që ka ky projektligj për sistemin e gjithmbarshëm ekonomik të Kosovës dhe për mbrojtjen e konsumatorëve, në veçanti.

Para dhe gjatë hartimit të këtij projektligji, janë bërë hulumtime dhe konsultime të gjëra, për natyrën e kësaj fushe. Arsyeja e hartimit të projektligjit të ri, për mbrojtjen e konsumatorit është vendosja e një kornize ligjore, e cila ka për synim të arrihet mbrojtja e të drejtave të konsumatorit, sipas standardeve ndërkombëtare dhe evropiane. Gjithashtu në Raportin e Progresit për vitin 2012, është cekur se Ligji për mbrojtjen e konsumatorit, dyshohet se nuk është përafuar me direktivat dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Projektligji, që tani e keni para jush, për mbrojtjen e konsumatorit, është përafuar me legjislacionin e BE-së, si dhe janë inkorporuar një varg direktivash të Bashkimit Evropian, në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, si:

- Direktiva për mbrojtjen e konsumatorëve nga praktikat mashtruese;
- Direktiva për marrëveshje të kredive për konsumatorët;
- Direktiva për mbrojtjen e konsumatorëve nga shitja në distancë;
- Direktiva lidhur me praktikat e padrejta tregtare, biznes-konsumator;
- Direktiva lidhur me praktikat agresive tregtare;
- Direktiva për mbrojtjen e konsumatorëve në përcaktimin e çmimeve të produkteve, të ofruara për konsumatorët;
- Direktiva në lidhje me reklamat çorientuese dhe krahasuese;

Projektligji për mbrojtjen e konsumatorit, përmban shumë dispozita të reja, në krahasim me ligjin nr. 2007/14, për mbrojtjen e konsumatorëve, që është në fuqi momentalisht.

Ndryshimet e propozuara në Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorëve, përcaktojnë në mënyrë më të plotë fushat e caktuara si:

- Etiketën,
- Deklaracionin e mallit,
- Zbritjet sezonale,
- Ofertën publike,

- Shitjen me aksion,
- Shitjen e mallrave me mangësi, gabime dhe defekte,
- Kërkesën e sigurisë së përgjithshme të mallrave dhe shërbimeve,
- Kreditë e konsumatorëve,
- Kontratat e lidhura në distancë,
- Kontratat derë më derë,
- Praktikën agresive tregtare,
- Praktikën mashtruese tregtare
- Reklamën krahasuese dhe mashtruese,
- Strukturën institucionale për mbrojtjen e konsumatorit,
- Arbitrazhin, si mjet alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjyqësorit,
- Mbrojtjen kolektive të konsumatorit,
- Shërbimet publike, të cilat u ofrohen konsumatorëve,
- Mirëmbajtjen e cilësisë së shërbimit publik,
- Informimin dhe edukimin e konsumatorit,
- Hartimin e kurrikulave, për mbrojtjen e konsumatorëve,
- Inspektimet,
- Dispozitat ndëshkuese e të tjera.

Ky ligj zbatohet për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet konsumatorëve, nga njëra anë dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve, ofruesve të shërbimeve në anën tjetër, me qëllim që të mbrohet konsumatori nga praktikën e padrejta, mashtruese dhe agresive tregtare.

Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren nr.09/2011, për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar Deklarata financiare nga Ministria e Financave, e cila parasheh se ky projektligj nuk ka implikime buxhetore, si dhe deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integritetit, se projektligji i sipër cekur është i harmonizuar me AKI, të BE-së.

Zbatimi i këtij ligji ndikon në:

- Rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës së institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut,
- Rritjen e sigurisë së produkteve dhe të shërbimeve të ofruara në treg,
- Vetëdijesimin e konsumatorëve,
- Zvogëlimin e numrit të keqpërdorimeve me produktet e hedhura në treg,
- Mbrojtjen e interesave ekonomike, shëndetit, ambientit,
- Preventivën dhe parandalimin e dukurive të mashtruesve, nëpërmjet plotësimit të kriterëve të caktuar të produkteve, si dhe
- Shërbimeve, që në projektligj i kemi specifikuar edhe shërbimet publike që u ofrohen konsumatorëve.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji në lëmin e ekonomisë dhe tregtisë, si dhe me qëllim të ofrimit të sigurisë në treg e në veçanti, mbrojtjen e konsumatorit, rekomandojmë që Projektligji për mbrojtjen e konsumatorëve të miratohet në këtë seancë plenare dhe të përkrahet nga ana juaj, të nderuar deputetë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit, ministre dhe zëvendëskryeministre! Kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti s'është këtu. Fjalën e ka kërkuar fjalën deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Falemnderit, kryetar i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë dhe

Ju të pranishëm,

Unë po flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit dhe që në fillim po e shpreh se e mbështesim në parim. Kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit në Komisionin Funkcional.

Por, më lejoni të ceku se mbrojtja e konsumatorit është një parim fundamental i të drejtave, në të gjitha vendet e botës. Edhe në vendin tonë e drejta e konsumatorit njihet si e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe me ligje të tjera në fuqi.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet të arrihet mbrojtje e të drejtave të konsumatorit, sipas standardeve ndërkombëtare.

Përafrimi i legjislacionit nga kjo fushë, përkatësisht i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, është një ndër prioritetet e Qeverisë dhe të Republikës së Kosovës, sepse ky akt ligjor në Raportin e Progresit të vitit 2011 është rekomanduar që të përafrohet me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, prandaj Qeveria e Kosovës ka vendosur që ky akt ligjor të jetë një ndër ligjet me prioritet për t'u ndryshuar në vitin 2012, të cilin e kemi miratuar si strategji legislative të Kuvendit, të vitit 2012.

Ne si Grup Parlamentar do ta japim kontributin tonë në fazën e amendamentimit. Ka disa vërejtje të natyrës ndoshta më tepër teknike të nenet përkatëse në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Vazhdojmë sipas grupeve parlamentare. Konsideroj se Partia Demokratike e kreu, kurse në emër të Lidhjes Demokratike Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Falemnderit, kryetar!

Zotni nënkryetar,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit dhe në parim do ta përkrahë atë.

Unë do t'i përmend vetëm disa çështje parimore, të cilat me siguri do të shqyrtohen nga Grupi Punues në komision. E para ka të bëjë me atë se në ligj duhet të ceket në mënyrë decitive se mbrojtja e konsumatorit përfshin edhe ne që jemi rezidentë edhe ata që janë

jorezidentë. Faktikisht, duhet në mënyrë decitive të ceket se konsumatori mbrohet. Në Kosovë çdokush mbrohet, pavarësisht a e ka shtetësinë tonë, apo të jashtme.

E dyta, ka të bëjë me një kuptim, po më duket jo të drejtë të çmimit me pakicë dhe shumicë. Me siguri, ministrja do të interesohet gjatë punës në komision. Ajo do ta shqyrtojë çmimin me pakicë apo me shumicë, që nuk ka të bëjë me atë a blihet shumë a blihet pak, a është për konsumatorin e fundit, apo është për shitje të mëtutjeshme, kurse në ligj lihet njëfarë dileme me çka ka të bëjë.

Ekziston një definicion që për mua ka qenë i paqartë - refuz çmimi. Nuk di, me siguri është përkthyer prej anglishtes, por është bërë një përkthim i keq.

Tjetër? Çështje tjetër është përgjegjësia për dëmet në mall apo paketim të mallrat, që i bart vetëm shitësi. Unë besoj se, përveç shitësit, duhet t'i bartë edhe prodhuesi, apo importuesi në rastin konkret. Nuk mund të jetë vetëm shitësi përgjegjës nëse e ka paketuar, apo e ka bërë para-paketimin, është krejt në rregull, por nëse shitësi e merr mallin prej prodhuesit përgjegjësia për çdo dëm i bie prodhuesit.

Është një çështje tjetër te faturimi i shërbimeve publike, në bazë të njehsorëve, posaçërisht te uji. Unë dyshoj se ne mund ta aplikojmë ligjin në praktikë, nëse e lëmë që faturimi i konsumit të ujit të bëhet vetëm në bazë të njehsorit. Ne jemi të vetëdijshëm se shumica prej nesh e paguajmë ujin me paushall, por pa kurrfarë njehsori, kështu që zbatimi i këtij neni në praktikë unë besoj se do të jetë jashtëzakonisht i vështirë, të mos them i pamundur, prandaj do të duhej gjetur një zgjidhje e mesme.

Sa i përket këshillit, vërejtja ime qëndron në atë se nëse këshilli është organ këshillëdhënës i ministrisë, nuk do të duhej t'i raportonte Qeverisë. Çdo organ që është këshillëdhënës, besoj se nuk ka nevojë t'i raportojë Qeverisë. Te organizatat, te bizneset, të cilat përfshihen në këshill, mendimi im është se nuk duhet të ceken me emër, por duhet të lihet një liri e Qeverisë apo e ministrisë në afrimin apo thjesht në emërimin e tyre, sepse përndryshe me siguri shoqata të biznesit do të kemi edhe më tutje dhe do të vihet në një pozitë që një shoqatë ndoshta në të ardhmen do të jetë jashtëzakonisht e organizuar, por nuk mund të përfshihet në këshill për shkak se nuk ekziston në ligj.

E njëjta gjë vlen edhe për Tribunalin e Arbitrazhit. Deri sa në këshill marrin pjesë tri shoqatat aktuale të biznesit, që i kemi në nivel të Kosovës, në Tribunalin e Arbitrazhit nuk është paraparë AKB-ëja. Nuk e di, është e mundshme që ato nuk janë në gjendje ndoshta ta kryejnë atë funksion apo atë punë, ndërsa atëherë do të duhej të jemi më fleksibilë në këtë çështje.

Në fund, ministrja e ceku se në Raportin e Progresit dyshohet. Unë nuk e kam hasur këtë fjalë se dyshohet. Ligji ose është i përafruar ose nuk është i përafruar. Raportin e Progresit, për shkak të raportimit të sotëm apo për shkak të shqyrtimit të ligjit, e lexova mbrëmë. Aty thuhet vetëm se nuk ka përafrim, apo nuk ka përparim në legjislacion. Kështu që besoj se fjala dyshim duhet të hiqet nga përdorimi dhe ajo që është e shkruar nuk përkon me memorandumin shpjegues. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Emrat nuk i kam, por shkojmë te Lëvizja “Vetëvendosja”. Kush e do fjalën, meqë nuk kam rrymë në monitorin tim. Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, kryetari i Grupit, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Falemnderit kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë në parim këtë ligj, edhe pse i kemi një mori vërejtjesh edhe teknike, por edhe substanciale, disa prej tyre, natyrisht, do t’i lexoj si vijon.

Së pari, është një vërejtje për gjuhën e ligjit, e cila shpeshherë shkakton edhe konfuzion të termave të përdorura, gjë që natyrisht shkakton edhe konfuzion pastaj në interpretimin e ligjit. Pra, ka shpeshherë edhe jokonsistencë ndërmjet gjuhës së përdorur, meqë në paragrafë të caktuar një përgjegjësi i jepet shitësit, e pastaj në paragrafin e mëposhtëm e njëjta përgjegjësi ceket si e prodhuesit apo e furnitorit, dhe në disa raste bëhet përdorimi i gabueshëm i termave shitës, furnitor apo prodhues dhe një lloj ndërkëmbyeshmërie e këtyre termave, e cila natyrisht e bën ligjin shumë vështirë të interpretueshëm dhe rrjedhimisht vështirë të zbatueshëm. Pra, duhet të kemi shumë më shumë kujdes në gjuhën që e përdorim, edhe nga aspekti juridik, por edhe thjeshtë nga aspekti gramatikor dhe sintaksor.

Një çështje tjetër që vërehet në këtë ligj është se në shumë raste, ligji është i ngarkuar jashtëzakonisht shumë me tekst dhe me përsëritjen e tekstit. Pra, i panevojshëm.

Një pjesë e mirë e projektligjit përmban tekst që përsëritet në nene të ndryshme dhe në raste të caktuara madje edhe ngërthen kontradiktat e brendshme në vetë nenet, por edhe në ligjin, në tërësi. Teksti duhet të rishikohet dhe duhet të shkrihen nene të caktuara, të cilat me dispozitat e tyre i rregullojnë situatat e njëjta apo të ngjashme dhe duhet të evidentohen ato teprica tekstuale, të cilat janë në këtë ligj.

Po ashtu, një çështje tjetër është edhe te dualiteti ligjor, meqë përpos kontradiktave dhe dualiteteve të ndryshme, ky projektligj e ka edhe një dualitet ligjor, i cili domosdoshmërisht duhet evituar, veçanërisht në rastin kur e rregullon çështjen e organizatave joqeveritare, të cilat merren me mbrojtjen e konsumatorit, ku ekziston dualiteti pra me ligjin për lirinë e asociimit dhe në disa raste, ta quaj ashtu, ka shpjegim të tepruar për atë se si duhet të mbrohet konsumatori në një sektor të caktuar, për shembull është te sektori i shërbimeve financiare, ndërkohë që te sektorët tjerë lë mangësi. Ne konsiderojmë se ky ligj duhet të jetë për mbrojtjen e konsumatorit, në përgjithësi, dhe pastaj sektorë të ndryshëm të veçantë rregullohen, ose me ligje të veçanta, ose me akte nënligjore për sektorë të caktuar të ofrimit të mallrave apo shërbimeve, pra të tregut, në përgjithësi.

Konsiderojmë se në rrafshin e mbrojtjes së konsumatorit nuk mjafton një departament në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, prandaj mendojmë se kjo është mënyrë e gabuar e rregullimit të kësaj çështjeje. Ne mendojmë që qysh në nenet fillestare duhet të themelohet një agjenci e pavarur për mbrojtjen e konsumatorit, e cila do të ishte organ i mbikëqyrur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, kompetencat dhe

detyrat e kësaj agjencie do të duhej të përcaktoheshin me këtë ligj dhe të qartësoheshin me anë të neneve të këtij ligji.

Themelimi i kësaj agjencie do të duhej të pasojë me kalimin sa më të shpejtë të kompetencave, të dokumentacionit dhe të informatave tjera përkatëse nga zyrat e veçanta për mbrojtjen e konsumatorëve te agjencia dhe pas fazës transitore këto zyra do të duhej të shuheshin, në mënyrë që të evitohej çfarëdo lloj dualiteti eventual apo konflikti i kompetencave që mund të rezultojë.

Agjencia duhet të jetë shtylla kryesore e mbrojtjes së konsumatorit dhe duhet të ketë kompetenca mbi çdo sferë të konsumit, konform legjislacionit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, një vërejtje goxha e theksuar është edhe te nenet 13 deri 18, të cilat flasin për deklaracionet, etiketat dhe informacionin që malli duhet t'ia ofrojë konsumatorit. E dimë se këtu në Kosovë vazhdojmë të kemi probleme të theksuara në këtë. Një pjesë e konsiderueshme e mallrave ofrojnë, për gjuhën shqipe e kam fjalën, informata jashtëzakonisht të mangëta për produktin, i cili blihet, ose në disa raste madje edhe nuk kanë fare, e kjo gjë duhet të përfundojë njëherë e përgjithmonë. E kemi pasur rastin me disa produkte, të cilat janë detyruar të tërhiqen nga tregu për shkak se kanë përmbajtur yndyrë derri, ndërkohë që në përshkrimin në gjuhën shqipe ajo është vlerësuar vetëm si yndyrë, pra ka qenë edhe keqinformim i konsumatorit për përmbajtjen e produktit.

Te neni 13, konsiderojmë që, përveç se duhet qartësuar faktin se informacioni mbi përbërjen duhet të jetë më i detajuar, paragrafi l i këtij neni nenit duhet të riformulohet, ashtu që ta zhvendosë përgjegjësinë për etiketim të mallrave nga shitësit te furnitori apo prodhuesi, për shkak se e dimë që mallrat kur vijnë, ose kur importohen, por edhe kur prodhohen, i tërë informacioni për të dhe ambalazhimi i tyre ndodh në atë moment dhe në atë pikë të zinxhirit tregtar, kështu që shitësi nuk e ka dhe nuk duhet ta ketë obligimin për këtë informim.

Dhe, të mos e zgjas shumë për shkak se kemi shumë vërejtje tjera, të cilat do t'i dorëzojmë natyrisht nëpërmjet komisionit, duhet cekur edhe një vërejtje tjetër që mendojmë se është e rëndësishme, e cila ka të bëjë me nenin 25, i cili mbulon kyçjen e konsumatorit në rrjetin e shërbimeve. Ne mendojmë se aty duhet të shtohet edhe një obligim tjetër shtesë, përveç obligimeve tjera që i ka ofruesi, i cili thotë që ofruesi duhet ta bartë koston e kyçjes së konsumatorit në rrjetin e shpërndarjes, pra përveç ofrimit të informatave.

Një çështje tjetër që në këtë ligj mbulohet, por që duhet të riformulohet, është edhe çështja e kontratave derë më derë në këtë nen, që e mbulon këtë çështje. Te kontrata derë me derë është një lloj mbrojtjeje e kontratave dhe vendosja e konsumatorit në një pozicion të palakmueshëm për shkak se thuhet që kontrata do të konsiderohet e vlefshme edhe në rast se konsumatori nuk është i informuar mbi detajet e kontratës në momentin kur e pranon ofertën. Pra, kjo çështje duhet të rregullohet ndryshe, natyrisht se konsumatori duhet paraprakisht ta ketë mundësinë që t'i ketë të gjitha informatat për

produktin apo shërbimin që i ofrohet, në mënyrë që pastaj kontrata të cilën ai e pranon të jetë dhe të pranohet si kontratë e ligjshme.

Pra, këto janë pak a shumë ato çështjet, të cilat desha t'i ngre, disa të tjera do t'i dorëzojmë në Komisionin Funkcional. Falemnderit.

KRYETARI: Falemnderit! Për t'u mbrojtur konsumatori me ligje të sakta, duhet ta mbrojmë gjuhën. Fjalën e ka, në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Fillimisht dua të them se edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështesë në parim këtë projektligj.

Mendojmë se projektligji ka provuar t'i rregullojë disa aspekte të mbrojtjes së konsumatorëve në Kosovë.

Sidoqoftë, dua të them se arsyeja e fundit për ta hartuar legjislacion nga Qeveria dhe për të kaluar legjislacioni nga Kuvendi, do të jetë Raporti i Progresit. Por, një ligj për mbrojtje të konsumatorëve duhet të bëhet për konsumatorët dhe për qytetarët e Kosovës dhe, në fund të fundit, arsyeja e fundit mund të jetë Raporti i Progresit.

Mendojmë se edhe ky ligj, si shumë ligje tjera, do të marrë shumë amendamente në Komisionin Funkcional. U përmend më përpara gjuha, u përmendën edhe disa paqartësi, të cilat janë vërejtur. Nuk do të hyj fare në detaje dhe po ashtu do të them se ndoshta për një kohë shumë të shkurtër, jo më gjatë se dy vjet, prapë do të duhet të amendamentohet ligji, ose të rishkruhet.

Mendoj se po ashtu duhet të përmendet se çështja e mbrojtjes së konsumatorëve është një spektër më i gjerë se sa mund të rregullohet me një ligj dhe një pjesë e madhe e elementeve të këtij spektri bien mbi Ministrinë e Tregtisë. Të mos harrojmë se mbrojtja e konsumatorëve është edhe kontrollimi i cilësisë së karburanteve, agjencitë e ndryshme bëjnë kontroll ose bëjnë mbrojtje të konsumatorit, sikur ajo e veterinës ose e barnave, ose rregullatorë të ndryshëm të ujit, të mbeturinave, të telekomunikacionit apo edhe të energjisë.

Mendoj se në këtë aspekt, përpos këtij projektligji, nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet të bëhet shumë më tepër.

Sidoqoftë, prapëseprapë, do ta votojmë ligjin në parim. Mendojmë se do të ketë punë në Komisionin Funkcional dhe shpresojmë se kjo punë të paktën do t'ia zgjasë pak afatin këtij projektligji, që të mos rishkruhet shumë shpejt edhe një herë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se sot e kemi në lexim të parë Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe ministrja tha mjaft qartë se ne e kemi një ligj në funksion, prapëseprapë është e vështirë ta kemi një ligj shumë efektiv për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, të shëndetit të tyre, të mjedisit, sigurisë jetësore dhe të çdo gjëje me të cilën përballen qytetarët e Kosovës.

Mirëpo, në deklarinimin e saj, ministrja tha se ne po përafrohemi me standardet e BE-së dhe shpresojmë që Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve të zbatohet në mënyrë të përpiktë, për arsye se edhe ne jemi konsumatorë, dhe edhe vetë Qeveria është konsumatore.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të gjitha sugjerimet që u dhanë sot në seancë nga të gjitha grupet parlamentare do të merren parasysh gjatë amendamentimit të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së, deputeti Mursel Halili e ka fjalën.

MURSELJ HALILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedniče Skupštine!

Uvaženi članovi Vladinog kabineta,

Gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa Samostalne Liberalne Stranke je razmatrala Nacrt zakona o zaštiti potrošača, i smatramo da je pred nama jedan dobar tekst, a i iz pratećih dokumenata videli smo da je ispoštovana i forma za donošenje istog.

Mi ćemo u načelu podržati ovaj Nacrt zakona, ali smatramo da ima i mesta za poboljšanje, i ja ću ovom prilikom da iznesem neka naša zapažanja.

U članu 3. gde postoji definisanje pojmova, smatram da bi trebalo da stoji i reč ili pojam "eksponat". Eksponat se spominje u daljem delu teksta, pa smatram da je potrebno da se objasni taj termin.

Takođe smatram da, obzirom da će ovi zakoni biti zasebno kada budu usvojeni i obavljani u Službenom listu Kosova, da kod ovog člana, definisanje trebalo bi da budu po nekom abecednom redu objašnjavani ovi pojmovi, jer će to lakše i mnogo bolje i preglednije objašnjavati i biti pristupačni za svakoga.

U članu 4., prava potrošača, vidim da ima dosta, i to je dobro, međutim mi smo došli do stanovišta da je potrebno još jedno posebno pravo promovisati odnosno predvideti, a to je pravo na promovisanje zdrave hrane. Ovo pravo bi trebalo da bude konkretizovano u posebnom članu, koji predviđa reklamiranje robe, a i pojasniću o čemu se radi.

Smatram da smo svi, kao potrošači, počev od najmanjih - dece, do najstarijih ljudi - građana, da nam je potrebno da se hranimo zdravo, i da bi trebalo promovisati ishranu, kao što je povrće, voće a ne više šećera, više ovih štetnih stvari, koje mogu da prouzrokuju oštećenje zdravlja.

Smatram da bi možda Vlada mogla nekim članom da predvidi da će podržati finansijski one medije i one listove, koje će promovisati ovu zdravu hranu.

Takođe smatram da u članu 8., u kome se predviđa žalba potrošača, nije predviđen rok u kom roku treba da se podnese žalba, i to bi mnogo pomoglo potrošačima da iskoriste svoja prava.

Sada bih hteo da kažem nešto oko informisanosti potrošača o robi, koju treba da kupe, odnosno o deklaracijama na robi. Smatram da je neophodno potrebno da svaka roba, svaki proizvod bude na službenim jezicima Kosova. Ima slučajeva kada na lekove koji se uvoze ne bude ispoštovana ova forma, pa dolazi do, recimo, problema u primeni tih lekova od strane ljudi koji nisu možda i razumeli tu deklaraciju, odnosno informisanost.

Zato, predlažem da svi lekovi i sva roba koja se nađe na tržište bude na službenim jezicima na Kosovu.

Dakle, još da spomenem da naša Parlamentarna grupa će podržati ovaj Nacrt zakona. Naravno, ove sugestije ćemo dati Funkcionalnoj komisiji na dalje razmatranje. Hvala!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit “6+”, fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Nakon analize Nacrta zakona za zaštitu potrošača, koji reguliše način i njihovu zaštitu, njihova prava i javno zdravlje, utvrđuje pravila za kupovinu robe i usluga na tržištu, kao i obaveze prodavca, proizvođača i dobavljača, Parlamentarna grupa “6+” je odlučila da podrži Nacrt zakona i svoj dalji doprinos daće kroz rad u Funkcionalnoj komisiji. Hvala vam!

KRYETARI: Tani e kanë radhën deputetët. Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke pasur parasysh se ky ligj adreson çështje shumë të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave themelore të konsumatorit, konsideroj se si i tillë duhet të përkrahet nga deputetët e Kuvendit, pasi pa i përmendur të gjitha të drejtat tjera, konsumatori, mbi të gjitha, ka të drejtë ta ushtrojë të drejtën e vet themelore, të drejtën për ta mbrojtur nga rreziku jetën dhe shëndetin e tij.

Miratimi i këtij projektligji është i domosdoshëm, sepse i përcakton rregullat dhe standardet për funksionalizimin e strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

Unë do ta votoj këtë projektligj, mirëpo komisionit përkatës do t’i kisha propozuar që me një nen të veçantë ta bëjë edhe rregullimin e restos, siç thuhet në gjuhën tregtare, ose ndoshta në gjuhën popullore. Do të ishte mirë ta përmendi në këtë rast kthimin e kusurit, sepse nëse konsumatori është i obliguar faktikisht të paguajë për mallin që e merr në dyqanet tregtare në Kosovë, ai nuk është i obliguar të kujdeset për t’ia bërë mjetet e imëta dyqanxhiut ose tregtarit, sepse në këtë rast konsumatori dëmtohet shpesh, ngase është i

detyruar, që në vend të kusurit, shpesh të marrë qoftë një qese palome, një stilolaps, apo një çamçakëz, gjë që është bërë shprehi nëpër dyqanet në Kosovë.

Prandaj, unë kisha propozuar që edhe kthimi i restos, ose i kusurit, të rregullohet me këtë ligj, në mënyrë që konsumatori i Kosovës të mos dëmtohet. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi të paraqitur të tjerë për diskutim. Tani hyjmë në procedurën e votimit.

Prezentë janë 63 deputetë! Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 57 vota për, asnjë kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e radhës është pika e shtatë:

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Komisionit për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, deputeten Safete Hadërgjonaj për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, kryetar!

Në pajtim me nenin 12 të Ligjit numër 03/L-084 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës, Komisioni për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale, në përbërje të guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, si kryesues, auditorit gjeneral dhe sekretarit permanent të Ministrisë së Financave, si anëtarë, i ka propozuar Kuvendit kandidatët për emërimin në Bordin Drejtuese të Fondit të Kursimeve Pensionale.

Komisioni për Buxhet e Financa, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2012, e ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale dhe ka vlerësuar se janë respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale për shpalljen e konkursit, intervistimin dhe përzgjedhjen e propozimit të kandidatëve për emërim nga Kuvendi.

Po ashtu, komisioni ka vlerësuar se në bazë të analizës së biografive të kandidatëve shihet se të gjithë kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore të parapara me nenin 4 të Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës, përkatësisht kandidatët e propozuar dëshmojnë se e kanë përvojën profesionale në çështjet e pensionit, të financave, të investimeve dhe të sigurimit.

Po ashtu, nga biografia e tyre mësohet se e kanë eksperiencën dhe përvojën ndërkombëtare në menaxhimin e mjeteve dhe në investimin e tyre, si dhe dëshmojnë se janë ekspertë në fushën e shkencave ekonomike, apo të financave, ashtu siç kërkohet me ligj, dhe përvojën e përfaqësimit apo këshillimit të interesave të punonjësve apo përfaqësuesve të tyre.

Gjithashtu, kandidatët e propozuar nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të qenë anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit, siç përcaktohet me nenin 4.12 dhe 4.13 të Ligjit për fondet pensionale të Kosovës, gjë që është konfirmuar edhe nga Komisioni për përzgjedhje, në bazë të testit të përshtatshëm dhe të duhur, që u është bërë kandidatëve.

Qeveria, në pajtim me nenin 4.11 të Ligjit për fondet pensionale të Kosovës, ia ka dërguar opinionin e vet Kuvendit, me të cilin ka mbështetur kandidatët e propozuar nga Komisioni për përzgjedhje.

Meqenëse kandidatët e propozuar nga Komisioni për përzgjedhje për emërimin e Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale i plotësojnë kushtet formalo-juridike, të parapara me nenin 4 të Ligjit për fondet pensionale të Kosovës, komisioni i rekomandon Kuvendit miratimin e propozimit të Komisionit për përzgjedhje për emërimin e anëtarëve dhe kryesuesit në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale me mandat 3-vjeçar, në pajtim me ligjin në fuqi. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Tani është radha në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, deputeti Behar Selimi e ka fjalën. Le të përgatitet pastaj kryetari i Grupit të LDK-së, Ismet Beqiri.

BEHAR SELIMI: Falemnderit, zoti kryetar!
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike pajtohet me rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa dhe do ta votojë atë.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër Grupit të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zotni kryetar!
Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës konsideron se të propozuarit i plotësojnë kushtet profesionale dhe ligjore, dhe do ta votojmë këtë propozim.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Së pari, një vërejtje që e kam thënë disa herë, po e them prapë. Është, mendoj unë, e padrejtë që ta votojmë një listë emrash të njerëzve që kanë edhe përvoja të ndryshme, edhe nivel profesional të ndryshëm, e të votohen në paketë, për shkak se kështu po e bëjmë votimin shumë më të vështirë dhe disa persona që ndoshta vërtet e meritojnë të jenë anëtarë të një bordi, ose të një institucioni, nuk po mund të kalojnë për shkak të disa tjerëve në listë.

Çështja e dytë është sa u përket këtyre emrave që janë propozuar për anëtarë të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale. Unë mendoj që informatat që na janë dhënë janë të mangëta për shkak se në Bordin e Trustit të Kursimeve Pensionale i kemi dy lloj anëtarësh, janë anëtarët profesionistë, të cilët i kanë kriteret profesioniste, që duhet plotësuar, dhe janë anëtarët përfaqësues, të cilët përfaqësojnë ose punëdhënësit e Kosovës, ose punëtorët e Kosovës.

Ndërkohë, në të gjitha këto shpjegime që na janë dhënë, qoftë nga Komisioni përzgjedhës, Qeveria, por edhe nga Komisioni i Kuvendit, nuk specifikohet në asnjë pikë se kush prej këtyre anëtarëve do të jenë anëtarë profesionistë, e kush prej tyre anëtarë përfaqësues.

Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh që disa prej këtyre emrave i njoh edhe personalisht, unë vetëm mund të supozoj se cilët prej tyre do të jenë përfaqësues. Mirëpo, duhet të na tregohet se për çfarë anëtarësh po votojmë dhe ta vlerësojmë përshtatshmërinë e tyre për pozitën të cilën e marrin.

Duhet ta kemi parasysh që Bordi Drejtues i Trustit të Kursimeve Pensionale është bordi ose organi kryesor dhe ekskluziv vendimmarrës për pensionet dhe për investimin e Fondit Pensional, pra të kursimeve pensionale të qytetarëve të Kosovës dhe duke i pasur parasysh rrjedhat ndërkombëtare në tregjet ndërkombëtare, ku këto para janë të investuara, atëherë vërtet duhet të jemi të kujdesshëm në atë se çfarë anëtarësh të Bordit po përzgjedhim, për shkak se këtu flitet për paratë e qytetarëve të Kosovës dhe për menaxhimin e tyre. Ndërkohë që disa prej emrave, sinqerisht po flas, jo që nuk i kanë përgatitjet profesionale, por nuk e kanë madje, konsideroj unë, dijen elementare për këtë punë, për të cilën është kërkuar të votohen.

Prandaj, duke e pasur këtë parasysh, dhe duke pasur parasysh po ashtu pamundësinë që t'i ndajmë dhe votojmë si emra të veçantë, atëherë Lëvizja "Vetëvendosje" nuk mund t'i votojë në paketë të gjithë. Falemnderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Falemnderit, i nderuar zoti kryetar!

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah dhe do t'i votojë anëtarët e Bordit të Trustit Pensional për arsye se i kanë plotësuar kriteret profesionale dhe kanë kaluar nëpër disa filtra, prandaj ne mendojmë se do ta kryejnë punën, me ç'gjë janë të përcaktuar me ligj. Falemnderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për miratimin e Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale me mandat trevjeçar, me anëtarë që janë propozuar në këtë listë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së, fjalën e ka Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala, predsedavajući!

Poslanička grupa Samostalne Liberalne Stranke je sa velikom pažnjom razmatrala predlog Vlade, guvernera i Komisije za budžet i financije o Bordu Fonda penzijske štednje Kosova.

Preporuke i predlozi su po nama nekorektni, jer od predloženih 5 članova, nijedan nije pripadnik manjinske zajednice. Ovo je naša velika zabrinutost, jer koliko smo primetili, sve je više ovakvih predloga članova Borda, i s toga Samostalna Liberalna Stranka glasaće protiv ovih predloga.

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, fjalën e ka deputeti Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit, i nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për përzgjedhjen e emërimit të kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale dhe meqenëse nuk ka asnjë propozim, i cili vjen prej radhës së komuniteteve pakicë, ne nuk do ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Shkojmë në procedurën e votimit?

(Ndërhyrje)

Të pranishëm janë 70 deputetë dhe lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 38 vota për-, 21 kundër dhe 5 abstenime, Kuvendi e miraton propozim-vendimin për anëtarët e Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës me mandat trevjeçar, si në vijim:

- Ymer Havolli, kryesues;
- Driton Qehaja, anëtar,
- Van Der Linden Wiliam, anëtar;
- Alan Piker, anëtar;
- Ruzhdi Morina, anëtar.

Tash vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011

Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011 e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti për arsyetimin e raportit me rekomandime. Deputeti nuk është këtu. Fjalën e ka deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Falemnderit, nënkryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 28.5.2012, e shqyrtoi raportin vjetor të punës për vitin 2011 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Komisioni vlerësoi se raporti i punës për vitin 2011, i parashtruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, është në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj, kryetare e komisionit.

SAFETE HADËRGJONAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Numër 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit i paraqet raport vjetor Kuvendit të Kosovës, i cili duhet të përfshijë edhe pasqyrat financiare të llogarive financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 2.5.2011, e shqyrtoi raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011 dhe vlerësoi se i njëjti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Numër 03/L-048 dhe Ligjit Numër 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit i ka paraqitur pasqyrat financiare për Buxhetin e Kosovës, të hyrat e dedikuara nga donatorët dhe pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

Buxheti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2011 ka qenë në vlerë prej 10 milionë e 289.863 euro. Prej tyre, 7 milionë e 772.688 euro kanë ardhur nga Buxheti i

Republikës së Kosovës, kurse 1 milion e 168.889 euro janë të hyra të dedikuara, si dhe 1 milion e 348.275 euro nga grantet e donatorëve.

Nga këto mjete, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka shpenzuar 9 milionë e 942.875 euro, apo 96.63% të buxhetit total.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, që nga periudha kur kompetencat kanë kaluar në kuadër të vendorëve, të paktën raportet financiare i ka sjellë shumë të detajuara, i ka paraqitur të gjitha shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive të shpenzimeve dhe ka ofruar të dhëna, ku secili ka pasur mundësi të bëjë analiza përkatëse në bazë të të dhënave, të cilat janë paraqitur, jo vetëm të këtë vit, por edhe në vitet e mëparshme.

Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa, meqenëse është në harmoni me ligjet të cilat i ceka më lart, ka rekomanduar që raporti të miratohet.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe ka ardhur në përfundim se ky raport është i punuar shumë mirë dhe i detajuar, është shumë transparent, prandaj ne si Grup Parlamentar do ta votojmë dhe njëherësh i ftojmë edhe grupet tjera që ta përkrahin dhe ta votojnë këtë raport. Falemnderit!

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike, në emër të Grupit Parlamentar, fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Falemnderit kryetar!

Zotni nënkryetar,

Ministër,

Kolegë deputetë,

Parimisht, Grupi Parlamentar i LDK-së, ashtu si edhe në fillim të seancës, mendon se raporti është i mangët në shqyrtim pa raportin e auditimit, i cili do të jepte një vlerësim më të qartë, apo një vlerësim më komplet mbi performansën dhe punën e AKP-së, duke filluar nga ajo se sa janë zbatuar rekomandimet e Zyrës së Auditorit Gjeneral, për të cilat nuk kemi kurrfarë të dhënash në raportin aktual të Agjencisë së Privatizimit.

Unë do të përmend disa çështje, të cilat është dashur t'i përfshijë raporti, megjithëse edhe ne vlerësojmë se nga ana formale raporti është i përpiluar siç duhet.

Raporti do të duhej të kishte përmbajtur edhe të dhëna mbi strukturën menaxheriale dhe numrin e përgjithshëm të punëtorëve, natyrisht përfshirë edhe lëvizjet që janë bërë gjatë vitit, avancimet apo eventualisht se sa punëtorë të rinj janë pranuar në agjenci dhe një përshkrim mbi procesin e rekrutimit.

Në raport mungon një pasqyrë krahasimore se çfarë është planifikuar dhe çfarë është arritur, apo çka është realizuar gjatë vitit 2011.

Sa u përket sektorëve të ndryshëm apo departamenteve të ndryshme që kanë të bëjnë me shitjen e ndërmarrjeve shoqërore, te spin-offet dhe te likuidimet është dashur të përfshihen edhe disa sqarime, se sa ndërmarrje kanë qenë pjesë e këtyre shitjeve, si të spin-offe-ve, ashtu edhe të likuidimit, si dhe natyrisht sa privatizime apo në sa raste kemi dështime për shkak të mungesës së ofertuesve, apo në sa raste janë anuluar, kur kemi pasur raste vetëm me një ofertë, apo të themi, në anën tjetër, se sa raste janë aprovuar kur kemi pasur shitje vetëm nëpërmjet një oferte.

Te ndërmarrjet e komercializuara nuk janë dhënë sqarime të bollshme, apo shpjegime për veprimet e AKP-së për vendimet që i ka marrë. Janë dy raste që përmenden edhe në raport, por nuk ka shpjegime, siç është rasti i FAPOL-it, të cilit i është vazhduar kontrata, apo rasti i fermës së shpezëtarisë, së cilës i është anuluar kontrata.

Te administrimi drejtpërdrejt, po ashtu jepen ndërmarrjet të cilat janë në administrim të drejtpërdrejtë, por nuk kemi sqarime të mëtutjeshme se ai administrim, në bazë të cilave ndërmarrjeve dhe për çfarë arsye është liruar nga administrimi i drejtpërdrejtë, apo cila ndërmarrje dhe për çfarë arsye është vendosur në administrimin e drejtpërdrejtë.

Kurse, në fund, unë besoj se sa u përket spin-offe-ve speciale është pika në të cilën më së shumti është lënduar, mund të them, kredibiliteti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e kjo do të duhej të ishte pjesë ndoshta e raportit të auditimit që ka të bëjë me performansën e AKP-së. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Njëjtë sikur që e thashë edhe në momentin kur flisnim për mocionin nga Grupi Parlamentar i LDK-së, ne konsiderojmë që ky raport nuk e pasqyron as për së afërmi punën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe nuk jep informata të mjaftueshme për atë që ne ta kemi mundësinë, pra ta vlerësojmë punën e kësaj agjencie, e cila formalisht bie nën mbikëqyrjen e Kuvendit. Pra, për shumë çështje të rëndësishme ky raport është jashtëzakonisht sipërfaqësor dhe në mënyrë shumë shpërfillëse i përmend disa prej çështjeve, të cilat kanë ngritur dhe vazhdojnë ta ngrenë një debat goxha të theksuar publik, veçanërisht te ato kontrata qoftë të spin-off-it special, apo të komercializimit të mëhershëm të ndërmarrjeve, të cilat janë vazhduar ose janë shkëputur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Pra, në këtë mënyrë është e pamundur të flitet për raportin e kësaj agjencie, prandaj unë do ta shfrytëzoj fjalën tim të flas pak për të.

Po bëhen tash thuaja 11 vjet që kur ka filluar procesi i privatizimit në Kosovë nëpërmjet të cilit janë përfunduar mbi 53 valë të privatizimit dhe nëpërmjet të cilit natyrisht janë shitur më shumë se 500 ndërmarrje të Kosovës. Pra, pjesa e konsiderueshme, më e

madhja e kapacitetit prodhues të Kosovës, që ka ekzistuar në formën e fabrikave dhe ndërmarrjeve tjera prodhuese, por edhe të ofrimit të shërbimeve, është privatizuar nëpërmjet këtij procesi dhe në atë kohë ky proces ka filluar me një lloj pompoziteti të madh se do të jetë zgjidhja kryesore për zhvillimin ekonomik të Kosovës, ndërkohë që ne sot, pas gjithë këtyre viteve, po e shohim që në fakt ka ndikuar në humbjen e mundësisë dhe në minimin e mundësisë së zhvillimit ekonomik të Kosovës për shkak se potencialin prodhues të Kosovës e ka ridrejtuar ose ridestinuuar në aktivitete tjera, të cilat natyrisht se nuk sjellin zhvillim ekonomik, dhe sipas sindikatave të Kosovës, diku 60% të punëtorëve që kanë qenë të regjistruar në këto ndërmarrje e kanë humbur vendin e punës si pasojë e drejtpërdrejtë e procesit të privatizimit. Dhe nëse një proces, gjysmën apo më shumë se gjysmën e punëtorëve të regjistruar i largon prej punës, atëherë nuk mund ta quajmë proces as të suksesshëm, e veçanërisht jo të dobishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, për shkak se krijimi i papunësisë nuk është në shërbim të zhvillimit ekonomik të vendit.

Të ndalem në disa çështje konkrete. Kisha dashur t'i përmend dy prej tyre, që kanë të bëjnë edhe me vitin e kaluar për sa i përket Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Pra, u përmend edhe nga parafolësit të ndërmarrjet e komercializuara, gjatë vitit të kaluar, ka qenë një privatizim i një ndërmarrjeje, një shkëputje kontrate dhe një vazhdim kontrate. Dhe raporti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk e merr mundin që ta shpjegojë arsyeshmërinë prapa këtyre vendimeve të këtij bordi, përveç se me tre paragrafë na tregon se çfarë ka ndodhur me këto çështje. Pra, po ndalem së pari te FAPOL-i, për të cilin nuk jep kurrfarë arsye pse i është zgjatur kontrata dhe çfarë ka qenë arsyeja e vendimit dhe racionaliteti i vendimit të një çështjeje të tillë, e ndërkohë që për sa i përket fermës së shpezëtarisë, nuk përmendet askund e vërteta tjetër, e cila ka dalë edhe publikisht nga komercializuesi i kësaj ndërmarrjeje, ku shihet qartë mospërmbushja e kontratës nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, e jo komercializuesi. Pra, prej momentit të komercializimit, kur është nënshkruar kontrata për këtë ndërmarrje, jo të gjitha objektet e kësaj ndërmarrjeje i janë dhënë në dispozicion komercializuesit, për shkak të pranisë së njësiteve të KFOR-it në ato objekte dhe rrjedhimisht komercializuesi, në pamundësi që ta përdorë kapacitetin e vet prodhues, nuk ka mundur t'i përmbushë edhe kushtet e kontratës, pra të punësimi i punëtorëve, por edhe të investimet tjera, të cilat është dashur t'i bëjë.

Po ashtu, mënyra se si është trajtuar kjo ndërmarrje lë shumë për të dyshuar në profesionalizmin e kësaj agjencie për shkak se, në njërën anë, është shkëputur kontrata në momentin kur kjo çështje vazhdon të jetë në gjykatat e Kosovës dhe duhet të trajtohet si padi e komercializuesit. Pra, në këtë rast kjo agjenci është dashur ta shtyjë vendimin deri sa të vendosë gjyqi për këtë çështje dhe nuk ka të drejtë ta përjashtojë komercializuesin nga ndërmarrja, të cilën e ka komercializuar, derisa të vendosë gjyqi për kontratën dhe përmbushjen e kontratës, në përgjithësi, dhe, në anën tjetër, është shkatërruar ky biznes, i cili në fazën e vet fillestare, por edhe në vitet e mesme të funksionimit të tij ka qenë një prej bizneseve goxha të suksesshme në Kosovë, dhe me informatat që i kam ka qenë edhe ferma e parë e shpezëtarisë në Kosovës, që ka pasur edhe certifikimin e standardeve ISO për një çështje të tillë.

Pra, kjo mënyrë e sjelljes së kësaj agjencie me këtë ndërmarrje të caktuar krijon shumë dyshime për mënyrën se si sillet kjo agjenci në përgjithësi me ndërmarrjet e Kosovës dhe në çfarë mënyre ndikon drejtpërdrejt në ekonominë e Kosovës, në këtë rast, duke e dëmtuar atë rëndë.

Një çështje e dytë, që nuk përmendet fare në raport, e cila ka qenë çështje edhe në Kuvend, është Fabrika e Tubave në Ferizaj. Pra, e dimë që Gjykata Kushtetuese ka vendosur në favor të sindikatës së punëtorëve të kësaj fabrike dhe në favor të një vendimi të Gjykatës Komunale të Ferizajt, e cila u jep të drejtë punëtorëve në kërkesën e tyre për borxhet që ndërmarrja ua ka punëtorëve.

Rrjedhimisht, ky vendim i Gjykatës Kushtetuese, i cili e obligon edhe Qeverinë, por veçanërisht Agjencinë Kosovare të Privatizimit që ta shlyejë këtë borxh ndaj punëtorëve, të cilin e ka caktuar Gjykata Komunale e Ferizajt, edhe sot e kësaj dite nuk është vënë në zbatim dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit faktikisht është duke e shpërfillur një vendim të Gjykatës Kushtetuese, i cili daton qysh nga 17 dhjetori i vitit 2010. Pra, po bëhet më shumë se një vit e gjysmë që kur Agjencia Kosovare e Privatizimit është duke e injoruar tërësisht Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. E, për këtë nuk e kemi asnjë fjalë të vetme në raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Prandaj, kur fola për mocionin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përmenda faktin qysh njerëzit përgjegjës për këtë agjenci duhet t'i japin përgjegjësi Kuvendit dhe unë konsideroj që nuk mjafton vetëm te komisioni për shkak se aty këto pyetje dhe këto përgjigje dhe këto kërkesa mund t'i marrin një numër i deputetëve, pra që janë anëtarë të komisionit. Mirëpo, unë konsideroj se kjo është në interes të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta dinë dhe ta kenë mundësinë ta nxjerrin të vërtetën për një agjenci kaq të rëndësishme për ekonominë e Kosovës dhe këtë ta bëjnë në një seancë, në të cilën ata do të raportojnë së bashku me raportin e shkruar dhe ku do ta kishin mundësinë që të ballafaqohen me pyetjet dhe brengat që i ngrenë deputetët.

Po ashtu, e dimë që Agjencia Kosovare e Privatizimit është në mbikëqyrje të ndërmarrjes “Trepça”, e në raportin e vitit 2011 thuhet që një numër i caktuar i aseteve të saj, që këtu po quhen jothelbësore, janë nxjerrë nga moratoriumi dhe rrjedhimisht janë bërë pjesë e planit të biznesit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që në terma të thjeshtë do të thotë se janë bërë pjesë e procesit të privatizimit, pra që do të privatizohen.

Përveç që na tregohet se këto janë nxjerrë nga moratoriumi për “Trepçën”, nuk na tregohet asnjë arsyeshmëri apo planifikim i Agjencisë Kosovare të Privatizimit se pse duhet shitur këto fabrika të caktuara, të cilat kanë qenë pjesë të “Trepçës”, dhe cila do të jetë mënyra e privatizimit të këtyre fabrikave. Pra, a do ta kemi edhe një privatizim, i cili do t'i shndërrojë këto fabrika në depo apo restorante, apo do ta kemi një privatizim, i cili do ta garantojë vijueshmërinë e prodhimit në këto fabrika, atë që e kanë pasur më parë? Pra, nuk thuhet asgjë në këtë raport.

Jemi duke folur për një prej ndërmarrjeve më të rëndësishme të Kosovës, të cilën e ka nën menaxhim kjo agjenci, e kjo nuk denjohet të na tregojë të paktën me një paragraf të vogël se çfarë e ka ndërmend të bëjë me atë ndërmarrje.

Te ndërmarrjet e tërhequra nga administrimi i drejtpërdrejtë u përmendën shpjegimet pse janë futur së pari në administrim dhe pastaj pse janë nxjerrë nga administrimi i drejtpërdrejtë, e ato janë shumë të thjeshta. Mirëpo, një gjë që vërehet këtu, e ndoshta kjo i është përvjedhur Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është që duke tentuar ta paraqesë punën e vet sa më të suksesshme, pra një njëfarë mënyre duke u munduar ta lavdërojë sa më shumë veten si agjenci, kjo tregon se në fakt kur i kanë marrë nën masa të administrimit të drejtpërdrejtë si agjenci, pra kur janë vendosur nën administrim të një agjencie shtetërore, këto ndërmarrje kanë filluar të performojnë shumë më mirë, gjë që nënkupton logjikisht se procesi i privatizimit të tyre nuk është i nevojshëm për shkak se këto ndërmarrje po mundkan të funksionojnë shumë mirë edhe si ndërmarrje shoqërore. Pra, një lloj lëvdate që ia bën agjencia punës së vet, e minon në një mënyrë jo të drejtpërdrejtë procesin e privatizimit dhe logjikën që është përdorur për privatizim deri tash në Kosovë, duke thënë se kapitali privat është më efikas në menaxhimin e ndërmarrjeve, ndërkohë që këtu agjencia thotë se ato kanë qenë më efikase kur janë menaxhuar nga agjencia. Pra, është një lloj përvijimi në ideologjinë e kësaj ndërmarrjeje, gjë që shkakton një lloj konflikti ndërmjet logjikës dhe arsyes që përdoret për punën dhe asaj që në fakt raportohet për të njëjtën punë.

Sa u përket pasqyrave financiare, unë prapë po them, nuk mund të flasim tash për shkak se këto duhet të auditohen dhe të shikohet e të vlerësohet së pari vërtetshmëria e këtyre.

Përfundimisht, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk mund ta votojë këtë raport, për shkak të këtyre gjërave që i përmenda deri tash. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka kryetari Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Në Kuvendin e Kosovës po shihen disa paradokse të çuditshme dhe interesante.

Kur Kuvendi debaton për çështje që janë shumë simbolike, dhe nuk e kam në plan t’i përmend, por të gjithë deputetët e dinë - çështje ekskluzivisht simbolike, na dalin dhe paraqiten për fjalë 50 deputetë ose më shumë, çështje të cilat kanë për t’i nxjerrë në televizion dhe për të treguar se njëherë jemi prindër të mirë, njëherë i mbështetim të drejtat e grave, njëherë tjetër kushedi çka tjetër, do të thotë Kuvendi ka tendencë të flasë për çështje simbolike, pa marrë vendim, në momentet kur nuk merr vendim, me nga 50 deputetë.

Ndërsa, kur flasim për tema jashtëzakonisht serioze paraqiten vetëm përfaqësuesit e grupeve politike, kurse deputetë tjerë nuk flasin.

Në rastin në fjalë, mendoj se një prej arsyeve kryesore është se në Kosovë fatkeqësisht ekziston një konsensus politik, për të cilin po ju garantoj se Aleanca nuk është pjesë e tij, që Agjencia Kosovare e Privatizimit mbahet kështu siç është.

Mendoj se ai konsensus politik është dashur të prishet, por nuk është prishur.

Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka marrë për bazë për t'i shitur të gjitha pronat shoqërore në Kosovë. Do të thotë, ta shesë pasurinë e Kosovës, me pretendimin se shitja e kësaj pasurie do t'i sjellë mirëqenie Kosovës, se ato ndërmarrje, të cilat kanë qenë shoqërore e do të shndërrohen në ndërmarrje private, do të kenë mundësi që të bëjnë biznes më të mirë, do të kenë mundësi që të punësojnë njerëz dhe ata do të marrin rroga, e tjera, e tjera.

Ne kemi parë në të gjithë vitet e fundit, ose prej fillimit qysh prej funksionon kjo agjenci, nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Do të thotë, Kosova nuk është zhvilluar ekonomikisht, punëtorët e Kosovës nuk janë punësuar në këto ndërmarrje, Kosova nuk ka përfituar prej këtij procesi të privatizimit. Kjo është e vërteta, dhe Kuvendi i Kosovës nuk gjen kohë të merret seriozisht e të debatojë për këtë çështje.

Më përpara unë thashë se ndoshta do të ishte mirë të bëhet një si praktikë që ta kemi edhe raportin e auditorit, mirëpo kam menduar se sot do të ketë debat. Mirëpo, po shihet se nuk ka debat, për shkak se ka konsensus politik, fatkeqësisht.

Sa për raportin, më duhet të pajtohem në emër të grupit se ato që janë shkruar në raport janë shkruar në rregull. Por këto nuk janë ato për të cilat ka nevojë informacion Kuvendi i Kosovës. Këto janë tabela dhe pasqyra, të cilat kemi mundur t'i marrim si shtojcë e një raporti kualitativ, i cili do të na tregonte se çka po ndodh, pse po ndodh, qysh po ndodh, cilat janë idetë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për të shkruar më tutje, dhe cilat janë idetë e tyre se si do të mund të shohim pak zhvillim ekonomik nga ky proces, se si do të mund të shohim pak zhvillim më të shpejtë të ndërmarrjeve publike, të cilat i përmendi parafolësi.

Ato ndërmarrje janë bllokuar. Janë bllokuar dhe u shërbejnë elementeve shumë të ngushta të shoqërisë kosovare, e në asnjë mënyrë nuk i shërbejnë mirëqenies së qytetarëve, apo punësimit të qytetarëve të Kosovës.

Në fund duhet të them, edhe pse ju thashë, se këto që shkruhen janë në rregull. Ne nuk mendojmë se Kuvendi i Kosovës dhe deputetët e Kosovës, si përfaqësues të popullit dhe populli i Kosovës, ka nevojë për këto tabela. Ne kemi nevojë për informacione tjera, të cilat nuk i kemi marrë dhe për këtë arsye nuk do ta votojmë raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Mendojmë se Kosova duhet ta zhvillojë një debat dhe ne do të ngulim këmbë që në momentin që do ta marrim raportin e auditimit për vitin e kaluar, në Kuvendin e Kosovës duhet të zhvillohet debat për gjithë procesin e privatizimit në Kosovë që prej themelimit

të agjencisë e deri më tani, por me fokus të veçantë, pas shpalljes së pavarësisë së vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe duke u bazuar në Ligjin e AKP-së, të miratuar nga pakoja e presidentit Ahtisari, shihet se raporti i AKP-së është një raport formal, e thashë edhe pak më parë. Është një raport, i cili në mënyrë tabelare e përshkruan gjendjen brenda AKP-së për çështjen e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Në rast se nisemi nga procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, atëherë shohim se ky proces që nga fillimi ka filluar thuaja se shumë gabimisht, mirëpo me një prapaskenë gjoja se do të ketë zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale. Pra, ai në efekt nuk e ka përmbushur këtë pritje të qytetarëve të Kosovës dhe kjo na e jep më së miri ta shohim çështjen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në kohën e UNMIK-ut - AKM-ja e atëhershme, dhe në kohën e tashme, pas pavarësisë së Kosovës - AKP-ja vendore, e cila dita-ditës po e degradon procesin e privatizimit, ku do të ishte më e rrugës që ajo të jetë një shtytëse e zhvillimit ekonomik të Kosovës, mirëpo po ndikon negativisht në këtë proces.

Këtu shihet mjaft qartë se në këtë agjenci ka procese të jashtëligjshme, korruptive, me shantazhe. Kjo shihet edhe në Komisionin Parlamentar, kur përfaqësuesit e AKP-së kur deklarojnë se puna brenda AKP-së është punë shumë e mirë me bordin e saj, mirëpo në efekt puna dhe politikat ekonomike të AKP-së janë duke i larguar investitorët e jashtëm dhe investitorët e brendshëm. Dhe kjo tregon më së miri si funksionon AKP-ja dhe çka bën AKP-ja apo Agjencia Kosovare e Privatizimit pas pavarësisë së saj, si dhe bordi i saj, gjë që e tregon mjaft mirë neglizhencën e saj ndaj investitorëve të jashtëm dhe të brendshëm, që tregon se është e aftë të mos i zbatojë ligjet, është e aftë të korruptohet dhe njëkohësisht të tregojë se ata janë baballarët e privatizimit në Kosovë.

Vendi ynë, Kosova, më shumë se kudoherë ka nevojë për investitorë, edhe të jashtëm dhe të brendshëm. Nuk ka nevojë për investime kapitale nga Buxheti i varfër i Kosovës.

Dhe, si Koalicion për Kosovën e Re, këtu në këtë Kuvend do ta parashtroj çështjen se a është më e rëndësishme të debatohet për çështjen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, siç e tha edhe zotëri Gjini, apo të debatohet me dy-tri fjalë dhe të kalojë një raport i tillë, me një bord të tillë, i cili bën neglizhimin e investitorëve.

Është momenti më i duhur për Kosovën që tash të ketë investitorë në këtë krizë. Dhe, duke marrë parasysh punën e Bordit të AKP-së, Koalicioni për Kosovë të Re kërkon që ky bord, në mënyrë ligjore dhe morale, të shkojë në shtëpi. Sepse, dështimi i tij është marramendës dhe duke dështuar AKP-ja po dështon edhe Kosova.

Politikat e Qeverisë dhe politikat e këtij vendi janë për një zhvillim ekonomik dhe punësim më të mirë. Dhe, në rast se AKP-ja është kundër këtyre politikave dhe kundër qytetarëve të Kosovës, atëherë ky bord i AKP-së lirisht, në mënyrë morale dhe ligjore, le të shkojë në shtëpi, sepse ka njerëz të mençur që dinë ta udhëheqin AKP-në. Ju falemnderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së? Nuk ka! Në emër të “6+”, nuk ka. Shkojmë me diskutimet e deputetëve.

Fjalën e ka kërkuar nënkryetari, Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Falemnderit, zotni kryetar i Kuvendit.

Kolegë të nderuar,

Nëse dëgjohet parimisht çka folën përfaqësuesit e grupeve, i bie se kjo pikë është dashur të shtyhet gjithsesi. Por ju e patë, votat u dukën ndryshe!

Kjo i bie të pajtohem me Ardian Gjinin për gjysmën e fjalimit të tij, e për gjysmën jo. Për të parën, parimisht, totalisht pajtohem me atë që e tha ai, sepse po duket, të gjitha grupet, filluar prej Grupit të LDK-së. Veçse, në Parlament instrument janë numrat, edhe Ardian Gjini i ka pak deputetë dhe LDK-ja nuk është e plotë.

Nëse i deklarojmë parimet, do të ishte mirë, po flas pra edhe për grupin tim, jo veç për të tjerët, për të gjithë, që ato t’i bëjnë vepra, sepse do të rrëshqasim në një hipokrizi që më nuk i besojmë njëri-tjetrit, e ata tjerët që na shohin atje, edhe më hiç, që e kemi seriozisht.

Ky joseriozitet për këtë institucion kaq të rëndësishëm, se e thanë të gjithë, dhe unë pajtohem, që është tepër i rëndësishëm për Kosovën, na bën të sillemi çuditshëm dhe ta shohim vetveten. Dhe, kjo shihet me mënyrën qysh u përpoqëm të kërkojmë seriozitet dhe e humbëm me votime, që i bie shumica do të bisedojë kështu, absolutisht sepse me vota thamë “po”.

Me dy raportet e komisioneve, nuk desha të flas në fillim, sepse desha t’i dëgjoj, njëri s’vjen hiç dhe s’e tha asnjë fjalë, ndërsa zonja që është deputete, Hadërgjonaj, e vyeshme, prandaj e përgëzoj, bile nganjëherë deri në vetëflijim, shkruan fjalime për çdo ligj, megjithatë është lodhur dhe raportin e vet formal e lexoi gabimisht.

Unë e di që kur ta them unë, ti do të çuditesh, por mos u çudit se e lexove shumë saktë, por e ke të shkruar gabim. E lexove gabimisht se e kemi mbajtur mbledhjen më 02.05.2011, se s’ka mundësi ashtu. Ti e lexove korrekt qysh e ke shkruar, por e ke shkruar gabim.

Domethënë, unë po lidhem këtu për të treguar që edhe më të kujdesshmit në këtë tip sjelljeje bëhen të pakujdesshëm, sepse lodhen.

Pra, të dyja komisionet, që në këtë rast do të duhej të na raportonin çfarë kanë vjelë në komision, në bisedë me drejtuesit e këtij institucioni, thanë zero fjalë. Unë si deputet tash

nuk e di, a i kanë takuar a nuk i kanë takuar, a e kanë marrë mendimin e tyre, a nuk e kanë marrë.

Komisioni e ka detyrim ta bëjë këtë para Kuvendit. Le t'i harrojnë këto shifra që mund të sjellin, 'ligji ky, neni ky', në bazë të këtij e ka shkruar, formalisht e ka bërë. Problemi është që të dalim nga formalizmat. Sepse, unë po besoj se ata njerëz shkruajnë mirë për punën që e kanë bërë dhe është detyrë e tyre që të shkruajnë mirë, formalisht. Veç formalisht dhe esencialisht, ky Kuvend e ka detyrë që t'i vlerësojë ata, t'i shohë çka kanë punuar, të marrë auditime çfarë të dojë dhe të japë vlerësim. Nuk është vetëvlerësimi vlerësim. Raportet për institucionet se kush i bën fantastike për veti, dhe është punë për ta. Prandaj, ekziston një institucion përtej tyre që i vlerëson dhe u thotë: 'Po, jeni kalueshëm ose s'jeni hiq, ose jeni të dëmshëm'.

Ky është një institucion kaq i rëndësishëm, që duhet të shikohet edhe performansa edhe perceptimi, zotni, dhe esenca, e jo forma. Një institucion që e ka hidhur në shitje pasurinë publike të Kosovës, me ligj. Po si, ku kanë arritur analizat, po ia nisim prej Ahmet Shalës e mbërrimë te Dino Asanaj. Shefa kanë qenë të dytë, kanë qenë dhe janë. Ti thuaj çfarë të duash, logjikën e bisedës s'ka njeri të zotë që ma ndërprejnë. Tani merre fjalën, s'ka problem. Nuk ma ndërpreve, ata janë shefa. Shefi është shef, me ligj, dhe ka pastaj edhe të tjerë.

Ahmet Shala dhe Dino Asanaj e kanë udhëhequr këtë. Unë jam këtu prej fillimit kur është bërë ajo agjenci, e shyqyr jam edhe sot. Nëse e kanë udhëhequr mirë ata duhet të lëvdohen, e të mos preken që po ju përmendi emrat, sepse e kanë bërë detyrën. Kështu që komisionet, por edhe ky Kuvend, nëse i mandaton ata është mirë. Unë nuk e di, po unë do ta shtroj pyetjen: A ka mandat Bordi, a ka mandat ligjor ende? Unë publikisht e di që para gati një viti gati, shefi i Bordit ka thënë: "Unë e kam kryer mandatin". Unë si deputet nuk kam informatë të plotë se a është rizgjedhur ai. Edhe shefi i Bordit, edhe të tjerët, që po thotë kolegu prej bankave, të gjithë sa janë. A kanë, unë nuk e di. Le të më thuhet: "Po, kanë, se e kanë rimarrë dhe e kanë". Unë nuk e di këtë.

Ndërsa, sa u përket vlerësimeve se çka është shitur dhe qysh është shitur, nëse ne bëhemi korrektë me vetveten dhe me rrethinën, dhe me perceptimin, e perceptimi nuk është e vërteta, unë vetë e them gjithë, sepse perceptimi është çelës që të shtyn ta kërkosht të vërtetën, atëherë duhet të flitet shumë për agjencinë qysh është punuar në sektorë dhe ku kemi arritur. Sepse, përndryshe, në të folurit publik, ato valë, që janë Vala e 50-të, s'di tash ka mbërri e pesëdhjetë e s'e di sata, ato valë kur t'i këqyrësh rezultatet nganjëherë duken si cunami, çka t'u dalë përpara ato e rrëzojnë, nuk e lënë gjallë kënd. Domethënë, duhet ta shohim a prodhojnë diçka, a forcojnë, apo veç rrëzojnë dhe e bëjnë vlerë të vogël, në mënyrë që të shitet lirë, në mënyrë që të mos ketë interes prej saj. Faleminderit!

Edhe njëherë po them, abstenimi, të flitet në Kuvend për këto probleme është problem i nderit dhe i parimit të deputetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Është në njëfarë forme një gjysmë replike. Unë pajtohem me zotin Hamiti se ka hipokrizi, po hipokrizia gjendet aty, ku në të njëjtën kohë kritikohet ashpër dhe në të njëjtën kohë mbështetet edhe më ashpër.

Isha shumë i interesuar me atë se me cilën pjesë nuk pajtohet. Me atë që pajtohet, e kuptova se e tha dy herë, po me cilën nuk pajtohet zoti Hamiti.

KRYETARI: Replikë, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Unë e di që Ardiani është, pa farë ironie, njeri i mençur, ka qenë edhe ministër dhe i di këto punë, bile edhe më mirë se unë. Mendova se kam qenë aq i qartë sa nuk kam nevojë t'i vizatoj kurrgjë në kuptimin e konkretizimit.

Kështu që, ajo që thashë mbetet. Unë nuk di çfarë të them më qartë se që thashë. Thashë që është ky Kuvend që duhet ta vlerësojë, thashë që me interesimin dhe mënyrën e sjelljes nuk po duket që do ta vlerësojë, thashë që është përgjegjës publik ky Kuvend, sepse e ka për detyrë ta vlerësojë një agjenci kaq të rëndësishme për Kosovën që ta bëjë në mënyrën më përfaqësuese dhe me argumentimet më të mëdha. Tjetër s'kam çfarë të them. Unë nuk jam ai që i kam të gjitha argumentet në xhep. Jemi 120 deputetë dhe unë besoj që në esencë unë nuk di me çka s'mund të pajtohesh çfarë po them. Kaq!

...ka ardhur këtu dhe me një vlerësim formal, qysh na kanë bërë komisionet, dhe me një diskutim formal nuk ka shans të bëhet vlerësimi i vërtetë i punës. Falemnderit!

KRYETARI: Deputetja Valbonë Dibra e ka fjalën.

VALBONË DIBRA: Falemnderit!

I nderuari kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po e diskutojmë raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për periudhën janar-dhjetor 2011. Disa herë gjatë diskutimeve dëgjova që zyrtarët e AKP-së e kanë sjellë në Kuvend një raport lavdërues, apo më mirë mos ta quaj "fantazmë". Unë besoj se askush nga zyrtarët e asnjë institucioni nuk e ka të drejtën të shkruajë lëvdata në një raport, të paktën pa e pasur një bazë ligjore, apo faktet që ekzistojnë.

Dhe, në kontekst të kësaj, unë i kam fokusuar disa çështje, të cilat do t'i them në vazhdimësi: Pas shqyrtimit të raportit vjetor, shihet se është përgatitur në mënyrë shumë të detajuar dhe shumë profesionale dhe e tregon një performansë të mirë të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Duke marrë parasysh aplikimin e ligjeve që janë aprovuar nga ky Kuvend, në shtator të vitit 2011, si dhe duke marrë parasysh që oda e veçantë nuk është funksionale dhe e pengon përmbylljen e aktiviteteve të agjencisë, si: përmbylljen e listave përfundimtare të punëtorëve, vendimet përfundimtare rreth masave të përkohshme të shqiptuara. Edhe përkundër krejt këtyre fakteve, janë gjetur mekanizmat që të bëhen pagesat për 20%-shin me shpërndarjet e përkohshme, ku vetëm gjatë vitit 2011 janë publikuar 22 lista fillestare dhe 71 lista përfundimtare, dhe është bërë

shpërndarja e pjesshme e 20% për punëtorët e kualifikuar të 82 ndërmarrjeve, në shumën prej 14.572.000 euro.

Po ashtu, gjatë vitit 2011 janë privatizuar 119 ndërmarrje të reja me 6 valë të privatizimit, respektivisht 130 asete në 5 valë të shitjes nëpërmjet likuidimit, që jep një mesatare prej 20 njësie për çdo valë, që krahasuar me raportet e viteve paraprake është dyfishim i punës. Nëse flasim për përmirësimet cilësore, shihet se çdo valë e shitjes transmetohet drejtpërdrejt që nga pranimi i ofertave e deri te përmbyllja e leximit të ofertave. Kjo është një dëshmi për transparencë të lartë në punën e agjencisë. Nëse i referohemi faqes 14 të raportit, shihet se ka pasur përpjekje për t'u dhënë mundësi investitorëve për t'i përmbushur kushtet në mënyrë që të funksionalizohen ndërmarrjet e mëdha që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Po ashtu, gjatë vitit 2011, shpenzimet e realizuara ishin 97% e buxhetit final. Kjo tregon se realizimi i buxhetit është pothuajse në përputhshmëri me buxhetin final dhe vlera e fondeve është rritur në 63,5 milionë gjatë vitit 2011. Investimet në afatizime kanë gjeneruar të hyra 4,2 milionë vetëm gjatë vitit 2011. Duke marrë parasysh ato që përmenda më lart, unë e përkrah këtë raport dhe njëherësh i ftoj edhe kolegët tjerë që ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Falemnderit, kryetar!

U thanë shumë gjëra për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, u diskutua edhe në parim për konceptin e privatizimit. Ka shumë elemente që ne si LDK ka kohë që i përsëritim dhe vazhdojmë t'i theksojmë, ndërsa theksi kryesor është se cili është koncepti ekonomik i këtij vendi, qysh do të zhvillohet ky vend, sa po japin potencial për zhvillim dhe si po përdoret ky privatizim për të mirën e qytetarëve të Kosovës, në kuptimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik? Të gjitha këto janë pyetje pa përgjigje.

Dhe një pjesë e rëndësishme e dështimit të zhvillimit ekonomik të Kosovës është edhe procesi i privatizimit për disa elemente. Elementi i parë është elementi i nxjerrjes së parave nga privatizimi jashtë vendit. Ju e dini se me qindra milionë euro janë nxjerrë nga ekonomia e Kosovës dhe nga tregu i kapitalit në Kosovë dhe janë deponuar jashtë. Kjo do të thotë se fuqia blerëse dhe mundësia e qarkullimit të parasë në Kosovë është me qindra milionë euro më e vogël. Kjo do të thotë se mundësia e zhvillimit ekonomik qëndrueshëm është shumë më e vogël. Kjo do të thotë se këto para, të cilat do të duhet të ishin në interes të qytetarëve të Kosovës, sepse janë para që duhet të hyjnë në interes të shfrytëzimit nga qytetarët e Kosovës, nuk janë në treg. Dhe, ky është një problem shumë i madh.

Problemi tjetër është mënyra e menaxhimit dhe procesi i privatizimit, si i tillë. Ne kemi njerëz këtu sot që janë në Kuvend dhe që diskutojnë, ose u kanë thënë të tjerëve që diskutojnë, që kanë marrë pjesë në procesin e privatizimit dhe ky privatizim ka pasur për qëllim zhvillimin dhe gjenerimin ekonomik, ndërkohë që fabrikat janë shndërruar në shitore dhe ato fabrika sot nuk prodhojnë. Lënda e parë është marrë dhe është shitur për

mbeturina, po ashtu makineria është shitur për mbeturina. Prandaj, ky është një koncept i dështuar ekonomik dhe kjo është një politikë, e cila është e gabuar për Kosovën. Ne nuk mund të kemi zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, në qoftë se nuk garantojmë që Kosova do të ketë prodhim të qëndrueshëm, të paktën për një pjesë të konsumit të vet. Ne nuk po flasim këtu për konsumin ndërkombëtar, nuk po flasim për daljen e produkteve të Kosovës në treg ndërkombëtar. Të flasim të paktën për konsumin e brendshëm. E nuk jemi në gjendje që ta furnizojmë konsumin e brendshëm.

Në qoftë se e shihni raportin e Bankës Qendrore të fundit, që ka dalë para një jave, ju mund ta vëreni se fuqia blerëse e Kosovës ka rënë. Ka rënë edhe importi, ka rënë edhe eksporti, që do të thotë se qytetarët e Kosovës janë varfëruar, që do të thotë që qytetarët e Kosovës nuk kanë mundësi të blejnë. Në qoftë se i shihni raportet, ju e shihni që kreditimi në Kosovë ka rënë, që do të thotë që mundësia e bërjes biznes ka rënë. Në qoftë se e shihni raportin e Bankës Qendrore, ju do ta shihni se janë rritur kreditë e këqija, që do të thotë se qytetarët e Kosovës, të cilët kanë marrë kredi, edhe ato konsumuese, edhe kredi të biznesit, nuk kanë mundësi t'i kthejnë ato. Kjo do të thotë se politikat ekonomike që i udhëheq kjo Qeveri janë të gabuara.

Prandaj, ne duhet ta kemi parasysh se segmenti i privatizimit është vetëm një pjesë e këtij dështimi. Ekonomia e Kosovës po dështon, sepse politikat ekonomike të kësaj Qeverie janë të dështuara. Prandaj, ne duhet t'i kemi parasysh këto elemente, duhet të jemi të vetëdijshëm se çka po u ofrojmë qytetarëve të Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës nuk po u ofrojmë mirëqenien, sepse një pjesë e madhe e kapitalit ekonomik të tyre nëpërmjet Agjencisë së Kosovare të Privatizimit është transferuar jashtë. Po ashtu, transferimi jashtë është bërë edhe nëpërmjet një komisioni tjetër, që ne më herët e votuam. Nga fondet pensionale paratë dalin jashtë. Ekonomia e Kosovës dhe mundësia e ekonomisë të Kosovës që të gjenerojë një zhvillim është shumë e vogël. Prandaj, duhet t'i kemi parasysh këto elemente, se ky koncept ekonomik, i udhëhequr nga kjo Qeveri, është koncept ekonomik i dështuar. Kaq kisha. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Do t'ju them edhe unë si deputet pak fjalë.

Të nderuar deputetë,

Ne si Kuvend vërtet jemi të obliguar, në rend të parë, që të gjitha raportet t'i shqyrtojmë mbi bazën e ligjeve dhe të Rregullores së Punës së Kuvendit. Për këtë jemi marrë vesh. Prandaj, jemi të obliguar t'i respektojmë edhe disa procedura. Por, nëse flasim për privatizimin në përgjithësi si proces, sigurisht se ky proces e ka një histori, dhe historia është më shumë se 10-vjeçare.

Dhe, tani nuk e kemi lehtë, pas 10 vjetësh, të kthehemi dhe në tërësi këtë proces ta shikojmë, a ka qenë në interes të Kosovës, apo jo. Kjo nuk është vështirë për t'u parë, se kështu siç është bërë ky proces nuk ka rezultuar në interes të privatizimit, në interes të punësimit dhe në interes të zhvillimit.

Megjithatë, mendoj që duhet të themi se sa i përket zhvillimit ekonomik, sa i përket pronës publike, gjatë gjithë këtyre viteve ne kemi pasur disa qeveri dhe mund të themi se Qeveria e Kosovës ose qeveritë e Kosovës kanë qenë në nivel të Kosovës, ato që e kanë

pasur një përgjegjësi më të madhe, pa i përmendur edhe ato që kanë qenë dhe janë udhëhequr nga ndërkombëtarët. Është Agjencia e Privatizimit që vërtet prej fillimit, plot 10 vjet ka qenë një qeveri në vete dhe mund të themi se në të gjitha grupet parlamentare i kemi njerëzit që janë marrë me privatizim gjatë këtyre viteve dhe në këtë s'mund ta abstraktojmë asnjërin, dhe të gjithë kemi pasur qejf që të fitojmë nga ky privatizim.

Gjithashtu, domethënë, është luajtur me pronën publike dhe me pasurinë e kombit. Gjithashtu edhe komunat kanë qenë pengesë për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kryetarët e komunave për pronën publike kanë qenë shefa dhe i kemi bërë shefa, që të bëjnë çfarë të duan me pasurinë publike. A është formuar ndonjëherë ndonjë komision për të hulumtuar, e kemi të drejtë ta bëjmë këtë edhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit, edhe me Kushtetutë. Me nënshkrimet e 40 deputetëve mund të formohet një komision hetimor për ta hetuar një agjenci, për të hetuar se si një komunë e menaxhon pasurinë publike, se si Komuna e Prishtinës e bën planin hapësinor dhe si ndërtohet e bëhet kaos urbanistik. A kemi diskutuar për këto çështje? Ne mund të themi se ky komision, të cilin e ka zgjedhur ky Bord, që e kemi zgjedhur ne së bashku, e pati filluar mirë, por, realisht, nga ajo që ne nuk kemi qare pa e shikuar edhe perceptimin se si është duke u perceptuar në kohën e fundit dhe nëse e shikojmë këtë, perceptimi është negativ. Pse komisioni që përbëhet nga deputetët e të gjitha subjekteve politike nuk e ka shkruar kërkesën për ta formuar një komision hetimor dhe për të hetuar se cila është e vërteta atje?

Dhe, megjithëkëtë, edhe po të formohet komisioni hetimor, ne si Kuvend nuk kemi mundësi ta dallojmë të vërtetën dhe ta dimë cila është e vërteta. A është e vërteta e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, a është e vërteta e atyre që tani dalin publikisht pse diku u janë shkelur interesat e tyre dhe janë krejt të sigurtë me ato deklaratimet e tyre.

Ne si Parlament e kemi vështirë ta verifikojmë këtë. Këtë duhet ta vërtetojë sistemi i drejtësisë, e në mënyrë të veçantë - Gjyqësia. Dhe, pastaj si Kuvend, nëse Gjyqësia duhet ta luftojë korrupsionin, nëse Gjyqësia duhet t'i luftojë veprimet e paligjshme të kryetarëve të komunave që kanë luajtur dhe vazhdojnë të luajnë me pasurinë komunale, dhe nëse korrupsioni është kaq i madh sa përflitet, cili është ndikimi i sistemit të drejtësisë dhe i Gjyqësorit në Kosovë? Megjithatë, unë dyshoj që Gjyqësori gjatë këtyre viteve ka ndihmuar shumë në tjetërsimin e pronës publike në Kosovë. Edhe në qytetin e Prishtinës, edhe në Komunën e Prishtinës, edhe gati thuaja në çdo komunë tjetër. Por, sa herë na janë prekur interesat, po e marr Prishtinën se është komunë e veçantë, e nuk po e abstraktoj asnjë komunë të Republikës së Kosovës.

Çdo pronë publike është duke u sakatuar nëpër komunat e Kosovës. Prandaj, të mos u vijë rëndë kur po them, se në privatizim kam marrë pjesë prej fillimit, e ju e dini se edhe Lidhja Demokratike me qeveritë e veta nuk ka pak përgjegjësi, as Aleanca, në gjithë këto politika që sot po i quajmë "të dështuara". Dështimin duhet ta marrim të gjithë së bashku se. Në fund të fundit, privatizimi gjatë këtyre viteve është bërë dhe mbështetur nga përfaqësuesit e të gjitha partive politike që janë në Kuvend. Dhe kur flasim për këtë, duhet të flasim vërtet për çdo keqpërdorim që është bërë. Dhe si Kuvend duhet të

shikojmë si kemi ardhur edhe ne në këtë Kuvend, që ne ta hedhim fajin tonë mbi një agjenci.

Megjithatë, unë jam që të diskutohet. Është momenti i fundit që në shoqërinë kosovare, në Kuvendin e Kosovës, në partitë politike të mos ketë debat për pasurinë e Kosovës. Vërtet, të debatohet seriozisht, të merren vendime, se vendimet në Kuvend po merren nga përfaqësuesit e partive politike dhe sikur të kishte debat të shëndoshë në partitë politike, do të kishte debat të shëndoshë edhe në Kuvend, dhe do të kishte përgjegjësi politike edhe në këtë Kuvend për pasurinë e Kosovës.

Dhe, tani jemi në fund. Ama duhet të shikojmë se të gjithë e kemi një përgjegjësi, të gjithë e kemi ngritur dorën pa e analizuar mirë se për çka po votojmë. Unë ju thërras që ne t'i kryejmë detyrat tona si Kuvend, t'i kryejmë detyrat tona si deputetë mbi bazën e ligjeve dhe të rregulloreve që i kemi. Nëse duam të ndryshojmë diçka nga baza e ligjeve dhe rregulloreve, qoftë dhe Kushtetutës që e kemi, ne duhet t'i ndryshojmë ato dhe duhet të kërkojmë zbatimin e tyre në të gjitha nivelet e pushtetit. Mos t'i orientojmë shigjetat vetëm në një nivel. Unë me qëllim thashë se tani për tani për zhvillimin ekonomik, për mbrojtjen e pasurisë publike është Qeveria, është agjencia, janë komunat dhe të mos e harrojmë kurrë sistemin e drejtësisë, i cili realisht për asnjë vepër të kundërligjshme në tjetërsimin e pasurisë nuk ka marrë asnjë vendim të rëndësishëm dhe të mos harrojmë se një segment, një e treta e sistemit të drejtësisë, gjatë gjithë këtyre viteve, është se avokatët e kanë pasur dhe vazhdojnë ta kenë një rol të rëndësishëm në tjetërsimin e pasurisë së Kosovës. Ju faleminderit për vëmendjen!

SABRI HAMITI: Jemi në demokraci, prandaj edhe pse po e udhëheqim bashkë, unë kam replikë me kryetarin e Kuvendit.

Në të vërtetë, unë duhet të shkoj edhe një hap më tutje, sepse ato që i tha kryetari i Kuvendit janë fenomene në zhvillimet në Kosovë, absolutisht. Problemi është tjetërkund. Artikulimi i tij ishte LDK-ja dhe AAK-ja dhe të mos flasin, prandaj këtu pushon pajtimi me atë. Punë e madhe, pikërisht nëse kanë qenë edhe AAK-ja dhe LDK-ja duhet të flitet dhe të ndërpriten praktikatat e këqija nëse ekzistojnë. Kjo s'duhet t'i çtrimërojë këta, po t'i kthjellojë. Nëse flasim për momentin, pushtetin e ka PDK-ja, pushtetin total, dhe zotni kryetar ti e di që e ka me 20% të votave të mundshme të qytetarëve të Kosovës. Po e kemi Kushtetutën e tillë, që e bën të mundshme që me 20% e sundon totalisht një vend, sepse në këtë moment në pozitë është PDK-ja. Dikur kanë qenë edhe të tjerat.

E dyta, ishte edhe nënvizimi "të gjithë kemi pasur qejf të fitojmë diçka". Pak a shumë, unë besoj që është saktë, sepse shënoj kur dëgjoj. Jo, jo, të gjithë jo! Qejf tinëz, çka imagjinojnë njerëzit, nuk e di, por është mirë përfundimisht të mos bëhen rrafshime se s'ka mbrojtje më e mirë e keqbërësve se kur deklarohet hapur një institucion si ky, "të gjithë jemi njësoj". As nuk jemi njësoj, as nuk punojmë njësoj. Të gjithë kemi divergjencë, prej formimit deri te veprimi. E ma kjo sa i përket punës të pushtetit, mos pyet sa dallojmë. Kështu që nuk është mirë, sepse të gjithë nuk jemi njësoj. Evidencat ekzistojnë edhe për temën konkrete, për të cilën po bisedojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Kaloi koha. Ardian Gjini, replikë.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Replika ime ka të bëjë me këtë çështje.

Ju të gjithë e dini në Kuvendin e Kosovës se kompetencat për mbikëqyrjen e agjencisë në institucionet vendore kanë kaluar në vitin 2008. Nuk ka pasur kompetenca vendore për agjencinë para vitit 2008, kanë qenë kompetenca të rezervuara, domethënë në atë kohë kur Aleanca ka qenë në pushtet për tre vjet.

Çështja tjetër është se pas vitit 2008, kur ju keni qenë në koalicion me LDK-në, edhe po të kishim kërkuar ne ta kemi një anëtar të Bordit nuk na do të na e kishit dhënë, le që s'kemi kërkuar. Dhe, çështja e tretë është: nuk është krejt e rastësishme, në fakt, gjatë gjithë kohës kryetari i Bordit ka qenë i PDK-së, e nuk ka qenë i Aleancës. Unë duhet t'i përmend nganjëherë, par exelans, domethënë pa përjashtim, vendor, se ka pasur edhe ndërkombëtar një kohë. Domethënë, Aleanca nuk e merr këtë përgjegjësi për të cilën folët ju sot. Nuk e merr këtë përgjegjësi për shkak se kur kanë kaluar këto kompetenca në institucionet vendore, ne nuk kemi qenë në pushtet, keni qenë ju me LDK-në dhe më duket ka mbetur gati i njëjtë Bordi. Falemnderit!

KRYETARI: Edhe unë do të bëj replikë!

Unë ndoshta duhet ta korrigjoj veten. Nuk kam menduar që të kuptohet ashtu siç e kuptoi nënkryetari Sabri Hamiti, por kam dashur të them që si fenomen nuk është i ri dhe përgjegjësinë për ta ruajtur pasurinë e vendit e kemi të gjithë si deputetë. Dhe, të gjithë e kemi të drejtën për ta thënë fjalën tonë. Edhe pse e kemi votuar në Kuvend një bord, unë nuk e quaj atë vetëm të Partisë Demokratike. Aty ka edhe të Lidhjes Demokratike, aty ka nga edhe nga sindikatat, që s'e di cilin orientim politik e kanë. Prandaj, mendoj që duhet të pyesim: A i kemi krijuar të gjithë mekanizmat për ta mbrojtur fuqishëm pasurinë publike? Dhe, duhet të themi si institucione, që kemi qenë dy herë në shumicë, e dy herë ka qenë shumicë Lidhja Demokratike. Nuk mund të themi se kemi menaxhuar mirë me pronën publike.

Pronën komunale e udhëheq edhe Partia Demokratike, edhe Komuna, edhe Lidhja Demokratike, edhe Aleanca, por unë mund të them që prona publike komunale nuk është duke u menaxhuar mirë, sepse kryetarët e komunave i kemi bërë mbretër. Edhe për një shërbëtor në shkollën fillore vendos kryetari i Komunës. Nëse vërtet nuk është kjo gjendje, atëherë dalim në terren, e argumentojmë dhe e shohim. Unë e abstraktova pak Prishtinën, ndoshta ia bëra pak Lidhjes Demokratike me hile, po realisht Prishtina si kryeqytet i Kosovës është në kaos urbanistik dhe dikush e ka përgjegjësinë për këtë.

Prandaj, unë u përpoqa të jem shumë korrekt nga keqpërdorimi i pasurisë publike komunale nuk e abstraktova asnjë komunë. Prandaj, nëse duam si deputetë ta kryejmë detyrën tonë, le të formohet një komision hetimor dhe të shikojmë aty ku del tymi, ku po bëhet zhurmë, aty të verifikojmë dhe ta bindim veten si njerëz që kemi përgjegjësi nga qytetarët e Kosovës: a është ashtu, apo nuk është ashtu. Edhe pse përsëri, po them, fjalën përfundimtare do ta thotë gjykata.

Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mendova që na sot do të përqendrohemi në këtë raport, në raportin domethënë që i përshkruan aktivitetet, por mendoj që është shumë mirë që u lëshuam në thelbin e këtij problemi, që është problem i gjerë. Nuk jam i sigurt që sot i kemi të gjitha elementet që ta diskutojmë çështjen e privatizimit.

Mendoj se pas kaq shumë kohe, më duket se edhe kryetari i Kuvendit propozoi, është mirë që Kuvendi ta mbajë një seancë tematike, një mbledhje plenare, në të cilën çështja kryesore e rendit të ditës do të ishte ta diskutojmë privatizimin. Ku kemi arritur dhe si do ta përfundojmë në mënyrën më efektive? Mendoj se për këtë kemi shumë arsye. Sa i përket raportit, ndoshta mungesa e tij është pse nuk i paraqet disa pengesa që në mjedisin ekonomik, politik dhe institucional, privatizimin në Kosovë e bëjnë joefektiv.

Roli kryesor i agjencisë është që ta ruajë vlerën e aseteve të privatizuara, por në qoftë se këto mjete mbahen të bllokuara dhe investohen me 0 deri 0,1%, kurse inflacioni është mbi 5%, kjo agjenci nuk e ka kryer funksionin e vet themelor, sepse vlera e aseteve të privatizuara është zvogëluar për 4%. Prej vitit 2011 është më e vogël se në vitin 2010. Mu për këtë, mendoj se agjencia është dashur ta bëjë këtë problem kryesor. Ku është problemi? Problemi është se sipas ligjeve që i kemi në fuqi, këto mjete duhet të mbahen të bllokuara ndoshta edhe 20 vjet. Të gjitha partitë politike nuk janë bashkuar me këtë, prandaj mendoj se faktore janë të gjitha partitë politike, sepse nuk e kanë dëgjuar alarmin që ua ka dhënë edhe shoqëria civile, edhe ekspertët, edhe të gjithë të tjerët.

Prandaj, ekziston nevoja që ne ta vëmë në rend dite privatizimin deri tash, por jo vetëm nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, por duhet të vijë edhe Qeveria. Qeveria duhet të vijë me raport, raportin e agjencisë e kemi, duhet ta kemi edhe raportin e auditorit për agjencinë. Qeveria duhet të vijë me raport, çka është duke u bërë me politikat e privatizimit? Le të vijë Qeveria këtu në një mbledhje dhe t'i analizojmë të gjitha këto aspekte dhe ta shohim edhe privatizimin e ndërmarrjeve publike. Çka po ndodh? Nisim ta privatizojmë PTK-në, mbetemi në gjysmë të rrugës. Nisemi me Kosovën C, mbetemi në gjysmë të rrugës. Nisemi me atë, mbetemi në gjysmë... Çfarë po ndodh?! Kuvendi nuk është i informuar mirë. Kuvendi ka nevojë të informohet edhe për privatizimin e ndërmarrjeve të ashtuquajtura "shoqërore", edhe për privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe t'i hartojë këto politika.

T'i verifikojë edhe njëherë politikat dhe qëndrimet e veta rreth privatizimit, sepse në qoftë se mbetemi kështu, ne vetëm do të diskutojmë dhe përsëri do të na riciklohet kjo situatë. Prandaj, propozimi im është konkret, që ne ta kërkojmë nga Qeveria një raport mbi rezultatet e privatizimit dhe politikat që ajo mendon t'i vazhdojë më tutje në privatizimin edhe të ndërmarrjeve shoqërore, edhe të ndërmarrjeve publike, dhe në kuadër të kësaj ta shohim funksionin dhe performansën edhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Sigurisht do të na vijë edhe raporti i performansës dhe do ta kemi një diskutim më frytdhënës. Sepse, tash nuk e dimë nëse vlen ai vendimi që e kemi sjellë me

buxhetin e vitit 2011 për privatizimin e PTK-së. Ai ligj e ka pasur vlerën për një vit. Unë mendoj që ministria është duke vazhduar me të njëjtin vendim.

Domethënë, ai vendim ka qenë ligj i buxhetit. Unë nuk jam i sigurt a vlen a nuk vlen? Çfarë po ndodh me Kosovën C? Unë kisha apeluar që ne të gjithë ta kërkojmë një raport gjithëpërfshirës dhe të bisedojmë për këto çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Mirë se erdhe, Fatmir!

Zoti kryetar,

Ministër, faleminderit për respektin se ata që janë kompetentë, ministrat që lidhen me këtë proces, nuk janë këtu. Ata janë duke u marrë me valën e radhës të privatizimit.

Unë pata të them diçka krejt tjetër, po më ndryshoi koncepti. Po filloj prej konfliktit të interesave në politikat e privatizimit. Meqë profesori Muhamet i përmendi, cilat janë konfliktet e interesit që nuk po thuhet këtu? Ne nuk mund t'i ndryshojmë politikat, por mund t'i zbatojmë sipas ligjit ato politika që janë sot. Është thënë që është ideologjik, bile aq shumë sa privatizimi po do t'ia ndërrojë ideologjinë PDK-së, nga një parti e majtë në qendër kah e djathta, për shkak të politikave ekonomike, respektivisht të privatizimit.

Më lejoni, më falni, nuk po dua të polemizoj. Me faktin që i kemi dy sindikata në Bord, është konflikti i parë i interesit ndërmjet punëtorëve dhe sindikatës. Sindikalistët e organizuar dhe fraksioni i tyre, i ndërtuar në konfederatë, ka shkuar e ka hyrë në Bord dhe është bërë pjesë e vendimmarrjes, duke rënë në konflikt të interesit me të drejtat e punëtorëve. Sepse, na u tha këtu, edhe i dimë, sa rastet gjyqësore janë, në të cilat punëtorët janë në kundërshtim të plotë me mënyrën se si ndodh ky proces dhe vendimmarrja, në veçanti, por përfaqësuesit e tyre votojnë dhe janë pjesë e procesit.

Konflikti i dytë i interesit është ai i Qeverisë me privatizimin, sepse së paku dy zëvendëskryeministra i ka në Bord, e njëri prej tyre është blerës aktiv në proces. Aq aktiv, sa në kohën e fundit u bë temë kryesore, se edhe zëvendëskryeministrit të parë po i bëhet shantazh, që është skandali më i madh, dhe nëse zëvendëskryeministrit të parë, nëse deputetit, i bëhet shantazh nga një agjenci, nga një organizatë, që është themeluar nga ne, atëherë ky është problem serioz.

Është blerës aktiv i një procesi kur Qeveria shet, e Qeveria nuk ka drejtë të blejë për vetë. Është konflikti më i rëndë i interesit që mund të ndodhë diku. Sepse, realiteti në Kosovë po e tregon një paradoks të radhës që po ndodh. Ky paradoks është i radhës dhe njerëzit duhet të zgjedhin. Nëse do t'i bleh asetet e shtetit, dil prej Qeverisë, e nëse rri në Qeveri, hiq dorë prej blerjes së pasurisë së shtetit!

Kjo është ajo pjesë e cila duhet të na mendojë më së shumti. Prona shoqërore, sipas ligjit, meqë Ardiani u bë korrekt edhe kallëzoi që në qeverisjen e tyre, por nuk tha në qeverisjen me LDK-në, se kanë qenë pakicë në atë qeverisje. E kanë pasur kryeministrin, fakt është,

por kryeministri i koalicionit LDK-AAK ka qenë faktikisht përfaqësues special i Sekretarit të Përgjithshëm. Ai ka qenë nënshkrues i kontratave nëpërmjet Shtyllës së Katërt. E kanë udhëhequr dhe nuk është turp të thuhet se e kanë udhëhequr. Drejtor ka qenë një ministër nga radhët e Aleancës, i cili ka bërë aq nder të madh, sa liderin e opozitës, kryeministrin e tashëm, e ka ftuar ta bëjë inaugurimin e “Ferronikelit” në Drenas.

Lideri i opozitës e ka bërë inaugurimin e procesit më të madh të privatizimit që qeverisja LDK-AAK e ka bërë, me të cilin na ka dalë problem. Atëherë, më lejoni të flas tash për pjesën tjetër. Mungesa e pranisë, që quhet Gjyqësor, sepse është një dallim i madh për procesin e privatizimit, është dhoma e veçantë e gjykatës që merret me këtë proces, e nuk merren organet tjera. Për të shkaktuar konfuzion, pastaj njerëzit shkojnë i drejtojnë lëndët në të gjitha shkallët e gjykatave, sikur rasti i Fabrikës së Tubave, apo rasti i Fabrikës së Radiatorëve. Po ua përmendi me qëllim, sepse zëvendëskryeministri i parë sot, për shkak të përfoljeve në fushatën zgjedhore, më pati dërguar 6 muaj në hetime, pa pasur faj dhe pa kurrfarë roli në atë punë.

Prokuroria Speciale më ka hetuar dhe ka konstatuar me shkrim se nuk kam pasur kurrfarë ndërhyrje, as kurrfarë roli, dhe sot blerësi faktik i fabrikës e ka marrë asetin dhe po e udhëheq. Nuk e di sa dhe qysh është bërë, por është bërë si e tillë, kurse pjesa më e madhe e procesit ka shkuar kështu siç po shkon. Ajo që është dallim i madh ndërmjet kësaj qeverisjeje dhe qeverisjes 2004-2008, Arben, është se ne kemi pas shumë më shumë privatizim spin-off special.

Kompanitë kanë qenë të kushtëzuara, edhe pse hoteli “Grand” po dështon për diçka. Nuk e di pse po dështon, po spin-off-i special megjithatë i ka kushtëzuar blerësit apo ndërmarrësit e rinj të merren me zhvillim, ta garantojnë numrin e punëtorëve, ta rritin numrin punëtorëve, të bëjnë plan biznesi, të garantojnë. Ka ecur, s’ka ecur, është çështje që tjetërkush e vlerëson. Dhe, duhet bërë bord. Tash po flasim për ndryshimin e këtij raporti, kurse problemi është ky.

Më falni dy minuta për asetet. Problemi është i 20%, shpërndarja e drejtë, sepse po u hyjmë në hak punëtorëve që i kanë ndërtuar, i kanë themeluar, meqë janë shoqërore, ata janë themelues të këtyre aseteve dhe padrejtësia po u bëhet atyre. Ata nuk po e marrin edhe më tutje në këtë ndarje të 20%, ndërsa 80% është problem dhe duhet bërë të qartë që ky fond 80% të ndahet ndërmjet të investuesve dhe shitësit. Ato nuk janë para të Kosovës. Duhet të konstatohet kush është investues. Investitor në Kosovë nuk është vetëm populli i Kosovës, është edhe Banka Botërore, ka asete. Janë edhe institucionet tjera financiare, si Klubi i Parisit, qeveritë tjera, e më së keqi është ajo që është quajtur Fondi Federativ për Zhvillim.

Por, sidoqoftë, disa borxhe na i kanë falë, paratë mbeten për Kosovën, siç është Banka Botërore dhe Qeveria amerikane. Borxhet ndaj Klubit të Parisit mbeten të hapura, duhen të shlyhen dhe pjesa tjetër e definimit. Mendoj që është shumë mirë të bëhet mekanizmi bllokues, që Qeveria e Serbisë, sikur që nuk ka akses, të mos ketë akses në 80%. Edhe më tutje po këto asete t’i lihen Kosovës edhe të njihen si të Kosovës.

Në fund, më lejoni, zoti kryetar, meqë i përmendët shumë komunat. Është fakt që kemi abuzim masiv me pronën komunale dhe keqpërdorim të Ligjit për PPP-të, i njohur si proces i ri në komuna. A ke mundësi të na tregosh sa komuna të PDK-së janë në hetime për tjetërsimin e pronës dhe sa prej tyre kanë për ta lëshuar detyrën shumë shpejt?

KRYETARI: Falemnderit! Jo, Ardian Gjini replikë, ti je i grupit të njëjtë.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, kryetar!

Mendoj se duhet edhe një përmirësim. Nuk po dua të hyj më tutje në këtë debat, por duhet qenë preciz.

Zoti Haziri tha që ka qenë drejtor ish-ministri, ish-anëtari i Aleancës. Po ju precizoj, edhe njëherë, mos e ngatërroni Aleancën, nuk ka qenë drejtor. Ka qenë zëvendëskryetar i Bordit, siç është Naser Osmani, tash për shembull, ndërsa kryetar ka qenë shefi i Shtyllës së Katërt, zëvendësi i Përfaqësuesit Special, ndërsa drejtor menaxhues ka qenë Ahmet Shala. Kjo është precize, domethënë kur e përmendim dikë duhet të jemi precizë. Nuk është e ngatërruar Aleanca në këtë temë, harrojeni këtë temë. Falemnderit!

KRYETARI: Edhe bash e pangatërruar nuk është. Lutfi Haziri, replikë.

LUTFI HAZIRI: Jo, unë nuk e përmenda emrin në kuptim negativ, por në kuptim pozitiv.

Përfaqësuesi më i lartë i Qeverisë së Kosovës në atë Bord ka qenë ministri i Tregtisë dhe ministri i Financave, përfaqësuesi më i lartë vendor. Tash kush ka qenë ndërkombëtar, ajo periudhë ka shkuar. Na po flasim post festum, kanë shkuar ata njerëz. Por përfaqësuesit më të lartë të Qeverisë, të mbrojtjes së interesave dhe përfaqësimit të interesave kanë qenë këta dy. Njëri ka qenë zëvendësdrejtor, njëri ka qenë anëtar, por kanë qenë si të tillë dhe nuk është marre të tregohet se kanë qenë. Sa i përket LDK-së, nuk besoj që është marre, e unë e mbroj këtë qëndrim.

KRYETARI: Realisht, ne kemi dalë nga rendi i ditës. Nëse kemi qenë të disponuar për të folur për këtë, është dashur të kërkohet debat dhe unë mendoj se e kemi pasur të drejtën ta zhvillojmë një debat për këtë. Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Privatizimi gjithsesi nuk është koncept i kësaj Qeverie, por i të gjitha qeverive të pasluftës për shkak se prej se është instaluar UNMIK-u në Kosovë, ai ka ardhur njëkohësisht me privatizimin. Na thoshin që nuk e kemi statusin e përcaktuar, rrjedhimisht nuk mund të marrim pjesë në atë manifestim ndërkombëtar, apo në këtë forum tjetër rajonal, mirëpo për privatizimin nuk ka pasur asnjëherë kurrfarë pengese mungesa e statusit.

Pra, pavarësisht a ishim nën administrimin e UNMIK-ut, më pastaj të EULEX-it, me pavarësi të shpallur, apo pa të, privatizimi ka qenë konstanta e jetës politike dhe ekonomike në Kosovë. Kjo do të thotë që privatizimi nuk ka qenë as koncept, sepse

privatizimi është sjellë si normë dhe si princip. S'ka qenë e lejueshme që të pyetet pse të privatizojmë, si të privatizojmë, çka të privatizojmë, kur të privatizojmë dhe sa të privatizojmë. Pra, duke qenë se këto pyetje kanë qenë të ndaluara, privatizimi nuk ka qenë as koncept. Privatizimi ka qenë pikënisje dhe ka qenë normë, e cila duhet të përmbushet medoemos.

Besoj që në ekonominë politike në Kosovë, kundërthënia themelore është ajo midis planit dhe principit. Pra, midis planit ekonomik dhe principit në ekonomi. Nuk është lejuar që në Kosovë të kemi fare plan ekonomik. Është konsideruar që planifikimi i përket një sistemi tjetër nga e kaluara, rrjedhimisht tash duhet ta kemi principin e privatizimit. Pra, kundërthënia themelore është vendimtare të identifikohet në mënyrë që ta zgjidhim problemin. Dhe, kjo kundërthënie themelore është ajo pra midis planit dhe principit.

Rrjedhimisht, ne sot kemi nevojë për plan ekonomik, e jo për princip të privatizimit në ekonomi, sepse pikërisht asisoj do ta lëmë shoqërinë pa ekonomi.

Nuk pajtohem se ka dështuar privatizimi. Janë kryer 55 valë të nxehta të privatizimit. Privatizimi ishte shumë i suksesshëm dhe ky është problemi. Pra, problemi ishte që ky privatizim, i cili u instalua si e vërtetë matematikore, si një aksiomë e padiskutueshme, pati shumë sukses dhe ne kemi aq shumë probleme, pikërisht nga suksesi i privatizimit. Ku ta marrin që të dështojë privatizimi, e të shpëtojnë publiku dhe shoqëria. Raporti i AKP-së gjithsesi është raport teknik dhe kjo për shkak se debati politik nuk është lejuar asnjëherë. Nuk ka pasur debat parlamentar kur është themeluar AKP-ja, nuk ka pasur diskutim publik lidhur me orientimet ekonomike, dhe rrjedhimisht, raportet e AKP-së, që vijnë sot, doemos janë teknike. Pra, politika i paraprin çfarëdo ekspertize dhe teknikaliteti, por në Kosovë ato tema nuk janë lejuar fare, sepse që prej përfundimit të luftës në institucionet e Kosovës kemi shumë më tepër përfaqësim në proceset politike, por jo pronësi në proceset politike. Pra, nuk kemi pronësi në procese. Kemi vetëm përfaqësim në procese, e kjo është arsyeja pse ne nuk e kemi fondin e privatizimit këtu, nuk mund ta përdorim për zhvillim, gjë që lidhet doemos me këtë pavarësi, pa sovranitet, që e kemi.

Pra, sovraniteti në Kosovë edhe më tutje mungon, e sovraniteti i shtetit drejtpërdrejt është i lidhur me të drejtën e vetëvendosjes së popullit, që njësoj mungon. Privatizimi nuk ka sjellë zhvillim ekonomik, por është interesant qysh nuk e ka sjellë as principin tjetër, liberalizimin. Pra, nga privatizimi nuk e fituam liberalizimin. E fituam kalimin e monopolit publik në monopol privat dhe përvoja e të gjitha vendeve të botës ka treguar që nëse duhet të kemi monopol, më mirë të jetë publik se privat. Më mirë është të mos ketë monopol. Mirëpo, nëse duhet të kemi monopol, kurrësi nuk bën të jetë privat. E në Kosovë, me privatizim e kemi ndryshuar pronësinë mbi monopolin nga duart publike në ato private, por nuk e kemi eliminuar monopolin si të tillë.

Pra, privatizimi nuk e ka sjellë liberalizimin. Kjo është një e vërtetë e hidhur në Kosovën e pasluftës. Dhe, tjetra është që nga privatizimi, si një e vërtetë matematikore, sepse asisoj është instaluar në Kosovë, nuk mund të diskutosh për të, është kaluar te e vërteta tjetër matematikore, që është infrastruktura, por jo infrastruktura në kuptimin e

ujësjellësit dhe kanalizimit, por vetëm të asfaltit. Është besuar që me të vërtetën matematikore, të quajtur “privatizim”, zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia vijnë vetvetiu, në mënyrë të natyrshme. Tash po thuhet se nëse e shtrojmë Kosovën me asfalt, zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia vijnë vetvetiu. Nuk ka ndodhur herën e parë, nuk ka për të ndodhur as herën e dytë.

Sepse, të dyja këto si principe nuk krijojnë vlerë të shtuar në ekonomi, nuk ka koncentrim të kapitalit, nuk ka akumulim të kapitalit. Ka veç qarkullim të kapitalit. Prandaj, kemi aq shumë tregti, kemi shitblerje, e nuk kemi prodhim. Dhe, sot në ekonominë botërore po e shohim që në krizën globale financiare po ia dalin mirë vetëm ato shtete, të cilat kanë prodhim. Dy degët tjera të ekonomisë, financat dhe shërbimet, janë të rëndësishme, janë të nevojshme, por kursesit nuk janë të mjaftueshme.

Gjithashtu, modeli i principeve të padiskutueshme të infrastrukturës si asfalt dhe të privatizimit të shpejtë, kanë bërë që të zhvillohet pesimizmi mbi ekonominë në Kosovë nga vetë popullsia e Kosovës, dhe jo vetëm nga politika. E keni parë qysh thonë, “investimet nga jashtë”. Të gjithë ne i duam investimet nga jashtë, por a e dini ku shkojnë 90% e investimeve direkte të huaja? Në vendet tashmë të zhvilluara. Veç 10% shkojnë në vendet e pazhvilluara, ose siç quhen me eufemizëm “vendet në zhvillim”. Pra, ne nuk mund të presim që zhvillimi të vijë nga jashtë, sepse ky është model pesimist i neoliberalizmit. Duhet dikush të na shpëtojë prej jashtë, prej lart. Zhvillimi nis dhe bartet prej brenda. E atëherë edhe i gjen aleatët e vërtetë, që të ndihmojnë.

Dhe së fundi, desha të them që nuk mund të luftohet korrupsioni nëse pikënisje e ke privatizimin, për shkak se korrupsioni është argumenti kryesor për ata që privatizojnë.

“Do ta shesim PTK-në, se ka korrupsion”, “Do ta japim me koncesion Aeroportin, sepse ka korrupsion”, “Do ta shesim Distribucionin e KEK-ut, sepse ka korrupsion”.

Këta njerëz e kanë korrupsionin të domosdoshëm, sepse e kanë privatizimin edhe më të domosdoshëm se sa luftimin e tij. Në momentin, kur privatizimin e ke princip dhe pikënisje, ti s’mund ta luftosh më korrupsionin. Se, ty korrupsioni bile të vyen, të vyen t’i shesësh ndërmarrjet. Vetëm në emër të korrupsionit, ti mund t’i shesësh ndërmarrjet.

Prandaj, një elitë, një konjunkturë politike, që e ka përvetësuar privatizimin si pikënisje dhe princip, kurrë s’mund ta luftojë korrupsionin, sepse ky është konflikt i interesit. Konflikt i interesit në rangun konceptual dhe ideologjik.

Dhe, së fundi, e kemi dëgjuar edhe ministrin Besim Beqaj, herën e fundit, i cili neve na thoshte se është rritur performansa e KEK-ut.

Atëherë, pse po e shesim? Nëse është përmirësuar performansa e KEK-ut, pse po e shesim?

Në fakt, ai e kishte ngatërruar dëgjuesin, se fjalët “është rritur performansa e KEK-ut” duhet ruajtur për korporatat, që duan ta blejnë shpejt dhe lirë. E, popullit duhet thënë se

ka shumë korrupsion. Pra, është njëfarë skizofrenie e brendshme në diskursin e atyre që duan të privatizojnë.

Rrjedhimisht, vetë privatizimi është paradoksal. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit!

Deputeti i fundit, i paraqitur, është Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Falemnderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrin besnik të Parlamentit!

Më lejoni, që së pari të them, jo për të justifikuar, por raportin që e shqyrton Komisioni për Buxhet dhe Financa objektivisht ka të bëjë vetëm me planifikimet financiare dhe shpenzimet financiare, e nuk ka faj kryetarja e komisionit, e cila ka për të raportuar, që në bazë të raportit nuk ka pasur asnjë vërejtje. Por, gjendja faktike, pas një raporti të mirëfilltë, të përgatitur mirë dhe në mënyrë statistikore, të numëruar mirë, do të duhej një vlerësim, ndoshta në aspektin e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe çka ka sjellë AKM-ja e përparshme, dhe AKP-ja e sotme.

Unë konsideroj se përkundër një vullneti të mirë, e këtu ndoshta dallojmë shumë edhe me zotin Kurti, realisht privatizimi ka qenë i pashmangshëm. Ky vullnet në mënyrë katastrofale ka qenë i keqpërdorur, njëherë nga ndërkombëtarët, e pastaj ka vazhduar me të njëjtin avaz edhe nga vendorët.

Në këtë aspekt, unë mendoj se nuk ka nevojë t'ia mbajmë rrotull, por të themi shumë hapur. Këtij Bordi të AKP-së nuk do të duhej ndoshta t'i skadojë kontrata, por do të duhej t'ia ndërpresim kontratën, sepse realisht nuk ka bërë asgjë.

Vetëm t'i përmend faktet, të cilat i njoh më së miri, sepse kam qenë i lidhur shumë ngushtë me procesin, të themi në Therandë, dhe spino-ffi special, si një mënyrë e vërtetë e privatizimit të ndërmarrjeve publike, ka qenë i tillë, që mbikëqyrja ndaj tij ka qenë katastrofale. Dhe, shih për këtë, një numër i madh i punëtorëve të OBI-t edhe sot e kësaj dite protestojnë që disa muaj dhe kush nuk dëgjon për vërejtjet e tyre.

Unë mendoj, zoti kryetar, që nëse hyjmë në tema të shumta, i hapim shumë tema, edhe të komunave, edhe të drejtësisë, edhe të kësaj, edhe të asaj, atëherë ka mundësi të shmanget problemi kryesor.

Sot, e kemi Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe do të ishte mirë të ndalemi aty. Ka mjaft probleme me këtë, që për komuna, ne opozita mund të japim edhe ndonjë vërejtje, por ju se sekretar i PDK-së, i partisë në pushtet, edhe kryetar i Kuvendit, ju mendoj se nuk mjafton vetëm të konstatoji. Ju keni për detyrë edhe t'i zgjidhni, sepse jeni parti në pushtet. Do të duhej të jepni propozime e zgjidhje, sepse edhe nëse kemi faje të përbashkëta, t'i zgjidhim sot, siç tha zoti Hamiti.

Të mos tolerojmë, në emër të asaj, që të gjithë kemi faj. Ka shumë deputetë, që i njoh këtu, që hiç nuk kanë fije faji në atë punë. Prandaj, mos ta vazhdojmë me këtë avaz, që ta

shpërndajmë, ta përgjithësojmë fajin dhe në këtë mënyrë, sikur disave u bie “shiu në kallamoq”, siç thuhet te ne. Ju faleminderit!

KRYETARI: Mundësitë për t’i keqinterpretuar fjalët ekzistojnë gjithmonë, prandaj nuk dua të merrem me atë.

Unë fillimisht ju thashë se edhe unë jam i bindur se nuk jemi të gjithë të njëjtë dhe nuk dua të jem me të gjithë i njëjtë. Po, të mos merremi me këto argumentime.

Unë tregova se ne duhet ta shikojmë çka kemi me ligj dhe çka është me Rregulloren e Punës së Kuvendit, atë e përcakton mirë, ndërkaq raporti me rekomandime, nga dy komisione, ka ardhur për miratimin e tyre.

Dhe, megjithatë, është dashur që fjala të thuhet diku tjetër. Por, të gjithë e kaluam atë hapësirën për çka ne kemi qenë të thirrur. Sot, e tejkalova edhe unë, si deputet, jo si kryetar.

Të pranishëm i kemi 65 deputetë. E votojmë raportin e komisionit me rekomandime. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 24 vota për, 26 kundër, 7 abstenime, raporti me rekomandime i komisionit nuk kalon. Pauzë. Në orën 15:30 kthehemi për vazhdimin e seancës.

(Reagime të deputetëve)

Mirë, e vazhdojmë seancën. Është vullneti juaj dhe imi.

Pika e fundit është:

- Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2011

Raportin vjetor të Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2011, e ka shqyrtuar Komisioni për Legjislacion dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2011, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Këtu janë mendimet e komisioneve.

Radha e diskutimeve. Fjalën e ka nënkryetari i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, deputeti Behar Selimi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

BEHAR SELIMI: Falemnderit, zoti kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin e punës së Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2011, dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë këtë raport të punës. Bazuar në të gjeturat gjatë analizave që i kemi bërë raportit të punës, i rekomandojmë Kuvendit që raporti të miratohet.

Nëse më lejohet, edhe në emër të Grupit Parlamentar, sugjerojmë që të aprovohet raporti i punës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Falemnderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, nëpërmjet edhe anëtarëve të vet në Komisionin Funkcional e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Ndihmë Juridike Falas. Ne mendojmë që në këtë drejtim është bërë avancim, sidomos nga shqyrtimi i këtij raporti prej vitit të kaluar dhe vetë ligji i ri, i cili është hartuar është në harmoni edhe me punën, të cilën ata po e bëjnë në shërbim të qytetarëve, të cilët kanë nevojë për ndihmë juridike.

Ne e përkrahim këtë raport. Tash së shpejti do të vijnë edhe propozimet, të cilat do t'i adresohen Komisionit dhe Kuvendit dhe do të kompletohet edhe Komisioni për Ndihmë Juridike Falas.

Komisioni e ka trajtuar pozitivisht dhe në bazë të rekomandimeve edhe Grupi Parlamentar shpreh opinionin pozitiv për raportin e punës së këtij komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputetja Albulenë Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Falemnderit, kryetar!

Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar raportin e Komisionit për Ndihmë Juridike Falas dhe duke marrë parasysh rolin që ka ky komision, pra ofrimin e ndihmës juridike falas për qytetarët tanë që janë në nevojë, ne sigurisht që do ta votojmë këtë raport. Por, shqetësimi ynë është buxheti, me të cilin operon ky komision.

Pra, këtij komisioni nuk po i ndahet buxhet i mjaftueshëm për të qenë më efikas, me gjithë kërkesat e vazhdueshme, që janë kërkesa edhe në këtë raport.

Pra, me këtë buxhet që i është ndarë, përveç që nuk është efikas, as nuk ka mundur të angazhojë më shumë avokatë, ngase ashtu i ka kërkuar Ministria e Financave. Andaj, po e shfrytëzoj rastin që të kërkoj nga Qeveria që ta ketë parasysh kërkesën e këtij komisioni, e kjo nuk po ndodh vetëm me këtë komision, por edhe me institucionet tjera, sidomos ato të drejtësisë.

Çështja tjetër është edhe informimi i vazhdueshëm, që duhet t'u bëhet qytetarëve për ekzistencën e këtij komisioni, pasi shumë qytetarë nuk janë të informuar se mund ta shfrytëzojnë një të drejtë të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Pa dashur ta zgjas shumë, edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon se ky raport duhet të kalojë. Po ashtu, mendojmë definitivisht se kemi raste, në të cilat ndoshta edhe kualiteti i ndihmës ulet për shkak të mungesës së buxhetit. Sidoqoftë, kjo është një temë që do të shqyrtohet më vonë edhe në Komisionin për Legjislacion, por edhe në komisione tjera të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka analizuar raportin vjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2011, dhe njëkohësisht përkrah edhe rekomandimet e komisioneve parlamentare dhe shpreson që në të ardhmen ky komision ta vazhdojë punën e vet në favor të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju falemnderit, kryetare!

Në emër të SLS-së, kush e do fjalën? Nuk ka të paraqitur. Në emër të “6+”? Nuk ka. Votojmë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim!

Të pranishëm 61 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 53 vota për, asnjë kundër, 2 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2011.

Ju lutem, në fund e kemi një njoftim!

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka emëruar Ismet Beqirin anëtar në Komisionin për Integritet Evropian, në vend vakant të së ndjerës Nekibe Kelmendi.

Mirupafshim në seancën e ardhshme!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë